


# Ndikimi i Rusesë në Dialogun Kosovë – Serbi të Ndihtuar nga BE-ja



KOSOVAR INSTITUTE FOR POLICY  
RESEARCH AND DEVELOPMENT

Përkrahur nga:



Londër, Mbretëri e Bashkuar

Qartësim:

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë vetëm të Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Të gjitha të drejtat e rezervuara KIPRED©2024

Kontakti:

Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1, 10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0)38 542 778

Web-site: [www.kipred.org](http://www.kipred.org)

Email: [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org)

Autorët:

Dr. Lulzim Peci dhe Dr. Bekim Sejdiu

Përkthimi dhe redaktimi:

Dr. Mentor Agani

Janar, 2024

## Përmbledhje Ekzekutive

Ky punim përpiket ta sqarojë rolin dhe ndikimin e Ruisë në kuadër të kontekstit të dialogut në rrjedhje e sipër midis Kosovës dhe Serbisë të ndihmuar nga BE-ja. Ky e ofron një hetim gjithëpërfshirës dhe të nuancuar të procesit të dialogut, duke shqyrtuar pasojat e tij më të gjera gjeopolitike dhe të sigurisë. Analiza përmban kontekstin historik të përfshirjes së Ruisë në marrëdhëniet e tendosura midis Kosovës dhe Serbisë në sfondin e shpërbërjes së Jugosllavisë. Kjo e hulumton ndërhyrjen e Moskës në dialogun aktual të ndihmuar nga Bashkimi Evropian midis Kosovës dhe Serbisë, duke i sqaruar objektivat e veçanta të Ruisë në këtë proces. Për më tepër, studimi hulumton kryqëzimin e dialogut me interesat rajonale, të sigurisë, ushtarake dhe ekonomike të Ruisë, duke hedhur dritë mbi implikimet në përpjekjet e Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

Ky punim vë në pah se qasja e Ruisë ndaj dialogut Kosovë–Serbi ka qenë jokonsistente, dhe është ndikuar nga evoluimi i marrëdhënieve me Perëndimin. Gjetjet mund të përmbliohen në tetë pika kyçe. *E para*, gjatë epokës së Jelcinit, politikat e Ruisë ndaj shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, përfshirë edhe Kosovën, u formësuan nga dy faktorë, dhe atë nga marrëdhëniet e përgjithshme të Ruisë me Perëndimin, si dhe nga botëkuptimet e vendimmarrësve kryesorë të politikës së jashtme në Moskë. *E dyta*, me shpërthimin e luftës në Kosovë, Rusia ishte pjesë e të gjitha përpjekjeve të mëdha ndërkombëtare për zgjidhjen e krizës. *E treta*, Rusia nuk i pranoi rezultatet përfundimtare të përpjekjeve ndërkombëtare për paqen në Kosovë, dhe atë kryesisht si shprehje e pakënaqësisë së saj të përgjithshme me Perëndimin. *E katërta*, duke qenë jashtë tryezës së negociatave në dialogun e ndihmuar nga BE-ja, qëllimi kryesor i Federatës Ruse është ta parandalojë dhe pengojë përfundimin e suksesshëm të procesit të dialogut, duke u përpjekur t'i diskreditojë BE-në dhe Perëndimin, dhe ta rivendosë rolin e KS KB-së. *E pesta*, Moska nuk e sheh procesin e dialogut të izoluar nga qëllimet e saj të përgjithshme gjeopolitike në Ballkan – posaçërisht nga qëllimi për ta mbajtur Serbinë dhe serbët brenda orbitës ruse dhe për ta penguar zgjerimin e BE-së dhe të NATO-s në rajon. *E gjashta*, lufta në Ukrainë e ka nxjerrë në shesh thellësinë e lidhjeve midis Ruisë dhe Serbisë. Rusia përpiket ta përdorë rastin e Kosovës si mjet pazari për të nxjerrë përfitime në Ukrainë dhe Gjeorgji, ashtu që t'i legjitimojë luftërat e veta aneksuese. *E shtata*, mungesa e unanimitetit brenda komunitetit euro-atlantik lidhur me Kosovën – me pesë vende të BE-së që ende nuk e njohin pavarësinë e saj – ka krijuar hapësirë më të madhe manovrimi për Rusinë. Dhe, *e teta*, një shtysë e rëndësishme

e Ruisë për të ndikuar në dialogun Kosovë–Serbi është fuqia e saj për ta bllokuar anëtarësimin e Kosovës në KB dhe në OSBE.

## Hyrje

Që nga vitet 1990-ta, Kosova, Serbia, dhe Ballkani në përgjithësi, janë shndërruar në një barometër për ta matur ndikimin (në rënie) të Ruisë në sistemin ndërkombëtar, dhe posaçërisht në Ballkan, që ka qenë një kryqëzim tradicional i interesave midis Ruisë dhe Perëndimit. Ballkani nuk është brenda sferës tradicionale të interesit kombëtar vital të Ruisë, ashtu siç është hapësira ish-sovjetike. Mirëpo, në thjerrëzat e Moskës, Ballkani e paraqet një tampon zonë strategjike midis “të fqinjësisë së afërt” të Ruisë dhe Perëndimit. Pos kësaj, Ballkani mbetet e vetmja hapësirë gjeopolitike e Evropës që nuk është e integruar në tërësi në strukturat perëndimore dhe që ende e ka një potencial të heshtur destabilizues për të tërë arkitekturën e sigurisë euroatlantike. Në këtë sfond, agresioni ushtarak që Putini e ka nisur kundër Ukrainës e ka shkaktuar një tendosje të pashembullt midis Federatës Ruse me SHBA-të dhe vendet e mëdha evropiane. Ndërkaq, ndezja e një rivaliteti kaq të fuqishëm midis Ruisë dhe fuqive perëndimore pashmangshëm e ka një pasqyrim tejet të madh edhe në Ballkanin Perëndimor.

Qasja e Ruisë ndaj dialogut të ndihmuar nga BE-ja midis Kosovës dhe Serbisë është formuluar në kuadër të këtij mjedisi. Ky punim synon të hedhë dritë mbi rolin dhe ndikimin e Ruisë në këtë dialog. Si i tillë, ky e jep një përshkrim gjithëpërfshirës dhe shumë-shtresor të procesit të dialogut dhe të implikimeve më të gjera gjeopolitike dhe të sigurisë që lidhen me të. Në këtë kërkim, analiza përfshin prapavijën historike të përfshirjes së Ruisë në marrëdhëniet e konfliktit midis Kosovës dhe Serbisë në sfondin më të gjerë të shpërbërjes së Jugosllavisë; ndërhyrjen e Moskës në procesin aktual të dialogut midis Kosovës dhe Serbisë që po zhvillohet me ndihmën e BE-së; qëllimet e veçanta të Ruisë në procesin e dialogut; kryqëzimin e dialogut midis Kosovës dhe Serbisë me interesat e sigurisë, ushtarake dhe ekonomike të Ruisë në rajon; dhe implikimet për qëllimin e Kosovës për anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare.

## I. Trajektorja e përfshirjes së Ruisë në dialogun Kosovë–Serbi:

### Nga Yeltsini e deri te Putini

Pas shpërbërjes së dhunshme të Jugosllavisë së Titos, Rusia fillimisht e mbajti jashtë çështjen e Kosovës duke kundërshtuar ndërkombëtarizimin e saj dhe duke mbështetur veprimet e Beogradit. Politika e jashtme e Ruisë u rreshtua më tepër me Perëndimin vetëm gjatë mandatit të ministrit të parë post-sovjetik të jashtëm rus, Andrey Kozyrev. Pavarësisht pikëpamjes mbizotëruese në qarqet e politikës së jashtme të Ruisë, Kozyrevi besonte se transformimi i Jugosllavisë në një avan-post ballkanik të Ruisë ishte jorealit. Ndryshimi në politikën e jashtme ruse ndodhi me 1996, kur Kozyrevin e pasoi Yevgeni Primakov. I ndikuar nga nostalgjia perandorake dhe teoritë e multi-polaritetit, Primakovi gravitoi drejt aleancave anti-perëndimore.<sup>1</sup>

Në këtë sfond, kur shpërtheu kriza në Kosovë në vitin 1998, Rusia tashmë ishte në rrugën drejt përplasjes me Perëndimin. Kjo u përkeqësua edhe më tutje nga vendimi i Aleancës për ta ftuar Poloninë, Republikën Çeke dhe Hungarinë në Samitin e Madridit të prillit 1997.<sup>2</sup> Politikat e Primakovit, që ishte një kundërshtar i vendosur i zgjerimit të NATO-s,<sup>3</sup> e nxitën edhe më tutje këtë përplasje, e cila u ngrit në një nivel tjetër në shtatorin 1998, kur ai u bë Kryeministër i Federatës Ruse. Aspekti thelbësor i “doktrinës Primakov” është pre-eminenca e Ruisë në hapësirën post-sovjetike dhe shtytjen gjithnjë e më të madhe për integrimin në mes ish-republikave sovjetike, drejtimin e të cilit do ta merrte Rusia. Një tjetër element kyç përfshinte kundërshtimin e zgjerimit të NATO-s dhe, në një shkallë më globale, përpjekjet e vazhdueshme për rrënimin e themeleve të institucioneve transatlantike dhe të rendit ndërkombëtar të udhëhequr nga SHBA. Një komponent tjetër thelbësor i strategjisë së politikës së jashtme të Moskës ishte partneriteti strategjik me Kinën. Këta tre elementë vazhdojnë të shërbejnë edhe sot si shtyllat kryesore të politikës së jashtme ruse.<sup>4</sup>

Me shpërthimin e luftës në Kosovë, Rusia fillimisht bashkëpunoi me Perëndimin duke mbështetur tri rezoluta të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KS KB) lidhur me

---

<sup>1</sup> Oleg Levitin, “Inside Moscow’s Kosovo muddle,” *Survival*, 42(1), fq. 133, 2000, IISS, London.

<sup>2</sup> Për një hetim më të thellë shih: Roland Asmus, *Opening NATO’s Door: How the Alliance Remade Itself for a New Era*, 2002, Columbia University Press, New York.

<sup>3</sup> Izvetiya, Summary of Primakov/SVR Report on NATO, National Security Archive, 26 nëntor, 1993, Në dispozicion në: <https://nsarchive.gwu.edu/document/16381-document-09-izvetiya-summary-primakov-svr>.

<sup>4</sup> Eugene Rumer, The Return of Global Russia: The Primakov (Not Gerasimov) Doctrine in Action, Carnegie Endowment for International Peace, qershor 2019, Në dispozicion në: [https://carnegieendowment.org/files/Rumer\\_PrimakovDoctrine\\_final1.pdf](https://carnegieendowment.org/files/Rumer_PrimakovDoctrine_final1.pdf).

krizën në Kosovë, që u miratuan sipas dispozitave të Kapitullit VII të Kartës së OKB-së. Në këtë drejtim, Rezoluta 1160 (1998) e KS KB, e datës 31 mars 1998, vendosi një embargo të armëve ndaj Jugosllavisë (Serbia dhe Mali i Zi – RFJ). Ajo i kërkoi Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë të mblidhte informata për dhunën dhe krimet e kryera në Kosovë. Është e rëndësishme që ajo theksoi se mungesa e “përparimit konstruktiv drejt një zgjidhjeje paqësore” në Kosovë mund të çojë në marrjen në konsideratë të masave shtesë.<sup>5</sup> Si përgjigje ndaj përshkallëzimit të konfliktit dhe përkeqësimit të situatës humanitare në Kosovë, më 23 shtator 1998 KS KB miratoi Rezolutën 1199. Kjo rezolutë e bëri një hap më tutje, duke theksuar qartë se kërcënimi buronte nga dhuna e ushtruar nga Policia Serbe dhe Ushtria Jugosllave ndaj popullatës civile të Kosovës, dhe në mënyrë të qartë përmendi mundësinë e autorizimit të “masave të tjera,” përfshirë këtu edhe ndërhyrjen ushtarake, për të ruajtur apo rivendosur paqen dhe stabilitetin.<sup>6</sup> Ndryshimi i qëndrimit të Rusisë, i shprehur përmes mbështetjes për këtë rezolutë të KS të OKB-së, rezultoi nga dështimi i Miloševićit për ta mbështetur marrëveshjen me Presidentin Yeltsin të 18 qershorit 1998, për të rifilluar negociatat me lidhshimin politik të Kosovës.<sup>7</sup>

Megjithatë, Rusia u përpoq haptas ose në mënyrë diskrete që ta pengonte nocionin e ndonjë zgjidhjeje që mund të shihej si e imponuar ndaj RFJ-së dhe që do të zbatohet nga NATO-ja. Nëse parandalimi i një imponimi të tillë do të dilte i vështirë, Rusia, të paktën, synoi të ruante një rol kontrollues në përfshirjen ndërkombëtare në rrjedhje e sipër në krizë nëpërmjet organeve ndërkombëtare, ku Moska e gëzon të drejtën e vetos (KS KB, Grupi i Kontaktit dhe OSBE-ja).<sup>8</sup> Lidhur me këtë, edhe pse Rusia e shprehu haptas kundërshtimin e saj ndaj përdorimit të forcës në mbështetje të Rezolutës 1199 të KS të KB-së, NATO-ja zyrtarisht kërcënoi bombardime ajrore kundër RFJ-së. Rrjedhimisht, më 16 tetor 1998 u shpall marrëveshja Milošević–Holbrooke që e parashihte themelimin e Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë dhe Misionit të Verifikimit Ajror të NATO-s në rajon.<sup>9</sup> Rezoluta vijuese 1203 (1998) e KS të KB, e miratuar më 24 tetor 1998, e mori në njoftim themelimin e misionit verifikues të OSBE-së në Kosovë dhe të misionit të verifikimit ajror të NATO-s mbi rajon.<sup>10</sup>

<sup>5</sup> KSKB, Rezoluta 1160 (1998), 31 mars, 1998. Në dispozicion në: <http://unscr.com/en/resolutions/1160>.

<sup>6</sup> KSKB, Rezoluta 1199 (1998), 28 shtator, 1998, Në dispozicion në: <http://unscr.com/en/resolutions/1199>.

<sup>7</sup> Alex Bellamy, J. *Kosovo and International Society*, Palgrave Macmillan UK, 2002, fq. 91.

<sup>8</sup> Marc Weller, “The Rambouillet Conference on Kosovo,” *International Affairs*, Vol.75(2), prill, 1999, fq. 212.

<sup>9</sup> OSBE/ODIHR, Kosovo As seen, As told, Analizë e gjetjeve për të drejtat njerëzore e Misionit Verifikues të OSBE-së, tetor 1998 – qershor 1999, 1999, Në dispozicion në:

<https://www.osce.org/files/f/documents/d/d/17772.pdf> .

<sup>10</sup> KSKB, Rezoluta 1203 (1998), 24 tetor, 1998. Në dispozicion në: <http://unscr.com/en/resolutions/1203>.

Megjithatë, efektiviteti i misionit të OSBE-së në parandalimin e konfliktit dhe të mizorive të Beogradit kundër popullatës civile në Kosovë u tregua i pamjaftueshëm. Pas ekzekutimit të 45 civilëve shqiptarë të Kosovës nga forcat e armatosura serbe në fshatin Reçak, më 15 janar 1999, NATO-ja e lëshoi një paralajmërim për Serbinë, duke shprehur gatishmërinë e vet për të përdorur sulme ajrore nëse është e nevojshme për të ndalur dhunën,<sup>11</sup> dhe i cili nuk u kundërshtua nga Rusia. I përballur me këtë kërcënim, Miloševići u pajtua për bisedime të paqes me shqiptarët e Kosovës nën përkujdesën e Grupit të Kontaktit (që përbëhet nga SHBA, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia), të cilat u mbajtën në Rambouillet (Francë). Konferenca e Rambouillet-së u kryesua nga Ministri i Jashtëm i Francës, Yber Vedrine, dhe Sekretari i Jashtëm i Mbretërisë së Bashkuar, Robin Cook. Megjithatë, negociatat u drejtuan kryesisht nga tre negociatorët e emëruar të Grupit të Kontaktit: Ambasadorët Christopher Hill (Shtetet e Bashkuara), Wolfgang Petritsch (BE) dhe Boris Mayorski (Federata Ruse).<sup>12</sup> Shqiptarët e Kosovës u pajtuan me Marrëveshjen Paqësore të propozuar nga përfaqësuesit e Grupit të Kontaktit,<sup>13</sup> dhe zyrtarisht e nënshkruan atë në Paris më 15 mars 1999, ndërkohë që Beogradi atë e refuzoi. Është interesante ajo që në nënshkrimin e marrëveshjes dëshmitarë ishin vetëm negociatorët e SHBA dhe të BE, meqë negociatori rus Mayorski refuzoi të merrte pjesë, duke tërhequr de facto mbështetjen për marrëveshjet në minutën e fundit në një përpjekje për t'ia rrënuar themelet përpjekjeve perëndimore.

Sidoqoftë, kjo strategji e Kremlinit në fund doli kundër produktive, si për Rusinë, ashtu edhe për Serbinë. Pas përpjekjes përfundimtare të pasuksesshme të të dërguarit të SHBA, Richard Holbrooke, për ta bindur Miloševićin që ta pranonte marrëveshjet e Rambouillet-së, më 24 mars 1999, NATO-ja filloi sulmet ajrore kundër RFJ-së, me qëllim të parandalimit të katastrofës njerëzore dhe që ta bënte Serbinë për t'i pranuar kushtet e paqes.<sup>14</sup> Dy ditë më vonë, më 26 mars 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB me një votim 12 me 3 (Kina, Rusia dhe Namibia) hodhi poshtë me vendosmëri një rezolutë të paraqitur nga Rusia, Bjellorusia dhe India, duke kërkuar ndërprerjen e përdorimit të forcës nga ana e NATO-s kundër RFJ-së.<sup>15</sup>

---

<sup>11</sup> NATO, NATO's Role in relation to the conflict in Kosovo, 15 korrik, 1999.

<sup>12</sup> Marc Weller, "The Rambouillet Conference on Kosovo," *International Affairs*, Vol.75 (2), prill 1999, fq. 227.

<sup>13</sup> Arkiva e Departamentit Amerikan të Shtetit, Rambouillet Agreement, Interim Agreement for Peace and Self Government in Kosovo, Në dispozicion në: [https://1997-2001.state.gov/www/regions/eur/ksvo\\_rambouillet\\_text.html](https://1997-2001.state.gov/www/regions/eur/ksvo_rambouillet_text.html).

<sup>14</sup> NATO, Deklaratë për shtyp, Dr. Javier Solana, Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s, 23 mars, 1999.

<sup>15</sup> Kombet e Bashkuara, Njoftim për Shtyp SC/6659, Këshilli i Sigurisë e refuzon kërkesën për ndërprerjen e shfrytëzimit të forcës kundër Republikës Federale të Jugosllavisë, 26 mars, 1999, Në dispozicion në: <https://press.un.org/en/1999/19990326.sc6659.html>.

Në më pak se dy muaj, Rusia ndërmori një zhvendosje të rëndësishëm duke iu bashkuar Perëndimit në kuadër të kornizës së G8-shit dhe duke u pajtuar me parimet e vendosura gjatë takimit të ministrave të jashtëm në Petersberg Center, të mbajtur më 6 maj 1999. Këto parime përfshinin elemente kyçe për arritjen e paqes, si tërheqjen e plotë e forcave ushtarake dhe policore të RFJ/Serbisë, dhe krijimin e një administrate të përkohshme të KB në Kosovë, ku që të gjithat e merrnin parasysh në tërësi Marrëveshjen e Rambujesë,<sup>16</sup> e cila u bë pjesë përbërëse e Rezolutës 1239 (1999) të KS KB, të aprovuar më 14 maj, 1999, në mesin e sulmeve ajrore të NATO-s.<sup>17</sup> Për më tepër, Rusia u rreshtua me përpjekjet perëndimore në kërkim të një zgjidhje diplomatike, duke e detyruar Millosheviqin që t'i pranonte kushtet e NATO-s. Në një takim të përbashkët në Bon, të mbajtur më 2 dhe 3 qershor, 1999, në të cilin merrnin pjesë Zëvendës Sekretari i Shtetit i SHBA-së, Strobe Talbott, i dërguari i Ruisë, Viktor Chernomyrdin dhe ish-presidenti finlandez, Martti Ahtisaari (në cilësinë e të dërguarit të BE-së), u arrit marrëveshje për një plan që do t'i plotësonte të gjitha kërkesat e NATO-s. Rrjedhimisht, Millosheviqi e pranoi planin më 3 qershor 1999.<sup>18</sup> Lufta përfundoi me 9 qershor 1999, me nënshkrimin e Marrëveshjes Ushtarako-Teknike (Marrëveshja e Kumanovës), midis Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë (KFOR) të udhëhequr nga NATO-ja, dhe Qeverisë së RFJ-së dhe të Serbisë. Kjo marrëveshje e parashihte tërheqjen e plotë të forcave të sigurisë së Beogradit nga Kosova dhe vendosjen e KFOR-it në rajon.<sup>19</sup>

Të nesërmen, më 10 qershor 1999, KS KB miratoi Rezolutën 1244 (me mbështetjen e Ruisë). Kjo Rezolutë i dha legjitimitet, dhe praktikisht edhe vulë ligjore, nga Këshilli i Sigurimit, rrethanave të reja të formuara nga ndërhyrja e NATO-s dhe Marrëveshja e Kumanovës. Rezoluta 1244 në mënyrë efektive e zhveshi RFJ-në nga çdo pushtet sovran mbi Kosovën. Në vend të kësaj, e miratuar sipas Kapitullit VII të Kartës së KB, Rezoluta autorizoi themelimin e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe vendosjen e misionit për zbatimin e paqes të udhëhequr nga NATO-ja – KFOR.<sup>20</sup>

---

<sup>16</sup> KB, Dokumente, Statement by the Chairman of the meeting of the G8 Foreign Ministers, S/1999/516, Në dispozicion në: <https://reliefweb.int/report/serbia/kosovo-statement-chairman-meeting-g-8-foreign-ministers>.

<sup>17</sup> KSKB, Rezoluta 1239 (1999), 14 maj, 1999. Në dispozicion në: <http://unscr.com/en/resolutions/123>.

<sup>18</sup> Daniel Williams, "Serbia Yields to NATO Terms," Washington Post, 4 qershor, 1999. Në dispozicion në: <https://www.washingtonpost.com/wp-srv/inatl/longterm/balkans/stories/belgrade060499.htm>.

<sup>19</sup> NATO, Military - Technical Agreement between the NATO's led International Security Force and the Yugoslav and Serbian Governments, 9 qershor, 1999. Në dispozicion në: <https://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>.

<sup>20</sup> KSKB, Rezoluta 1244 (1999), 10 qershor, 1999. Në dispozicion në: <https://digitallibrary.un.org/record/274488?ln=en>.



Rusia iu bashkëngjiti misionit të KFOR-it të udhëhequr nga NATO-ja, mirëpo ajo fillimisht e bëri një aksion ushtarak provokues, për ta marrë nën kontroll aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës më 12 qershor 1999. Ky e përfshiu një dislokim të befasishëm të 200 paratrupave nga kontingjenti i saj i SFOR-it në Bosnje dhe Hercegovinë,<sup>21</sup> për ta përgatitur terrenin për dislokimin e trupa shtesë nga Rusia përmes transportit ajror. Duke e krijuar një prani ushtarake domethënëse pa ndonjë paralajmërim paraprak, Rusia synoi të trajtësonte realitete të reja në terren, dhe ta krijonte një zonë në hapësirën me shumicë serbe në pjesën veriore të Kosovës, nën komandën ruse.<sup>22</sup> Ky veprim në mënyrë efektive do të kishte hedhur dyshime mbi besueshmërinë për zbatimin e mandatit paqësor nga ana e KFOR-it të udhëhequr nga NATO-ja. Sipas ambasadorit të atëhershëm serb në Rusi, Bora Milošević, Marshalli Sergeyev e informoi atë se kontingjenti rus mund të shkonte nga 3,000 deri në 10,000 njerëz, ndërsa kryeministri Stepashin përmendi 5,000 trupa, me kërkesë të buxhetit të vlerësuar në rreth 150 milion dollarë.<sup>23</sup> Megjithatë, ky plan nuk u materializua meqë, ndër të tjera, Bullgaria, Rumania dhe Hungaria ia refuzuan autoriteteve ruse shfrytëzimin e hapësirave së tyre ajrore.<sup>24</sup>

Presidenti Putin vendosi ta tërhiqte kontingjentin rus nga Misioni i KFOR-it në korrik 2003, duke e ndërprerë kështu praninë ushtarake në Kosovë.<sup>25</sup> Mirëpo, ky vendim i Kremlinit nuk u shoqërua edhe me një tërheqje politike dhe diplomatike. Zyra e Ambasadës Ruse ka funksionuar në Prishtinë që nga fillimi i Misionit të KB-së në Kosovë në vitin 1999. Rusia nuk hoqi dorë nga interesat e saj në Kosovë, por, në vend të kësaj, e bëri një zgjedhje strategjike që ndikimin ta ushtronte kryesisht përmes kanaleve diplomatike dhe përmes Serbisë, meqë ajo objektivat e politikës së jashtme i ndoqi kryesisht përmes rivalitetit dhe madje edhe armiqësisë me Perëndimin në rajon.<sup>26</sup>

Në kontekstin e përcaktimit të statusit përfundimtar të Kosovës, Rusia u angazhua sërish në kuadër të Këshillit të Sigurimit të KB dhe të Grupit të Kontaktit. Më 15 nëntor 2005, Këshilli i Sigurimit i KB miratoi propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm të KB, Kofi Annan, për

---

<sup>21</sup> Patrick Wintour dhe Ian Traynor, Russian and British Troops in tense Pristina Stand-off, The Guardian, 13 korrik, 1999, Në dispozicion në: <https://www.theguardian.com/world/1999/jun/13/balkans5>.

<sup>22</sup> BBC, Confrontation over Pristina Airport, 9 mars, 2000, Në dispozicion në: <http://news.bbc.co.uk/1/hi/world/europe/671495.stm>.

<sup>23</sup> Vladan Vlaković, *Military Secret, Part I*, Helsinki Committee for Human Rights in Serbia, Beograd, 2004.

<sup>24</sup> BBC, Confrontation over Pristina Airport, 9 mars, 2000, Në dispozicion në: <http://news.bbc.co.uk/1/hi/world/europe/671495.stm>.

<sup>25</sup> NATO Update, Russian Troops Leave Kosovo, 10 korrik, 2003, Në dispozicion në: <https://www.nato.int/docu/update/2003/07-july/e0702a..htm>

<sup>26</sup> Lulzim Peci, Russia's Information Warfare Against Kosovo, Political Background and Manifestations, Policy Brief, KIPRED, tetor 2020. fq. 8.

emërimin e Martti Ahtisaarit si i Dërguar Special për Procesin e Statusit të ardhshëm të Kosovës.<sup>27</sup> Për më tepër, takimi i Grupit të Kontaktit në nivel të ministrave të jashtëm, që e përfshinte edhe Rusinë, dhe që u mbajt në Londër më 31 janar 2006, miratoi parimet udhëzuese për përcaktimin e statusit të Kosovës. Këto parime theksonin se “nuk duhet të ketë kthim të Kosovës në gjendjen e para-1999-ës; nuk duhet të ketë ndarje të Kosovës; dhe as bashkim të Kosovës me ndonjë shtet tjetër apo me ndonjë pjesë të ndonjë shteti tjetër.” Më e rëndësishmja, parimet udhëzuese përcaktuan se “ministrat shikonin që Beogradi ta mbante në mend se zgjidhja, ndër të tjera, duhej të ishte e pranueshme për popullin e Kosovës,”<sup>28</sup> gjë kjo që e hapi derën e pavarësisë. Duhet theksuar se këto “parime udhëzuese” u përkrahën nga Moska.

Për shkak të mungesës së përparimit në negociatë, Grupi i Kontaktit në nivel të ministrave të jashtëm, më 20 shtator 2006 e udhëzoi Presidentin Ahtisaari që ta “përgatiste një propozim gjithëpërfshirës për një zgjidhje të statusit dhe që, mbi këtë bazë, t’i angazhonte palët në lëvizjen përpara të procesit të negociatave.” Grupi i Kontaktit theksoi se “përpjekja për një zgjidhje të negociuar nuk duhet ta errësojë faktin se asnjëra palë nuk mund ta bllokojë në mënyrë të njëanshme avancimin e procesit të statusit.”<sup>29</sup> Në pajtim me këto udhëzime, Presidenti Ahtisaari më 2 shkurt 2007 ia paraqiti Kontakt Grupit Draftin e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës,<sup>30</sup> i cili i jepte konturat e pavarësisë ë mbikëqyrur për Kosovën. Më 26 mars 2007, Sekretari i Përgjithshëm i KB e miratoi propozimin dhe ia përcolli KS KB draftin përfundimtar të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.<sup>31</sup>

Ndërkohë, qëndrimi konfrontues i Rusisë kundër Perëndimit po përshkallëzohej. Vendimi i administratës së George W. Bushit për të vendosur raketa interceptuese dhe instalime radarësh në Poloni dhe në Republikën Çeke, i fillimit të vitit 2007, shkaktoi reagime të forta nga Putini. Ai këtë e shihte si një veprim që do të prishte “stabilitetin strategjik botëror” ekzistues dhe që

---

<sup>27</sup> UN Meetings Coverage and Press-Releases, Secretary-General appoints former President Martti Ahtissari of Finland as Special Envoy for the Future Status Process for Kosovo, 15 nëntor, 2005. Në dispozicion në: <https://press.un.org/en/2005/sga955.doc.htm>.

<sup>28</sup> Kosovo Contact Group Statement, London, 31 janar, 2006, pikat 6 dhe 7. Në dispozicion në: [https://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms\\_data/docs/pressdata/en/declarations/88236.pdf](https://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/declarations/88236.pdf).

<sup>29</sup> Kosovo Contact Group Ministerial Statement, 20 shtator, 2006. Në dispozicion në: <https://2001-2009.state.gov/r/pa/prs/ps/2006/72892.htm>.

<sup>30</sup> Joint Contact Group Statement, 2 shkurt, 2007. Në dispozicion në: <https://2001-2009.state.gov/p/eur/rls/or/79892.htm>.

<sup>31</sup> UNSC, Letter from the Secretary-General addressed to the President of the Security Council, S/2007/168, 26 mars, 2007, Në dispozicion në: <https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kosovo%20S2007%20168.pdf>.

kërcënonte me një Luftë të re të Ftohtë.<sup>32</sup> Nga ana tjetër, Rusia edhe një herë, dhe ngjashëm me Konferencën e Rambouillet-së, në ndjekjen e rivalitetit me Perëndimin zgjodhi që ta sabotonte procesin e KB për statusin e Kosovës, duke u kërcënuar që do ta përdorte veton për ta bllokuar propozimin e të Dërguarit të KB, Martti Ahtisaarit.<sup>33</sup> Kremlinin u rreshtua me Serbinë, me qëllim të shndërrimit të Kosovës në një konflikt të ngrirë të pafund, me qëllim që ta godiste Perëndimin në zonat e tij të cenueshme, dhe të përpiqej të kërkonte përfitime transaksionale në fqinjësinë e vet në të ardhmen.

Për të bërë një përpjekje përfundimtare për kapërcimin e bllokimit në KS KB të shkaktuar nga Rusia, në mënyrë të ngjashme me bisedimet e Rambouillet-së, Grupi i Kontaktit në Takimin Ministror të 27 shtatorit 2007 e caktoi një trojkë negociatorësh të udhëhequr nga ambasadori gjerman Ischinger, duke përfaqësuar Bashkimin Evropian, me diplomatin e lartë rus, Alexander Botsan-Harchenko, dhe ambasadorin amerikan Frank Wiesner. Më 4 dhjetor 2007, ashtu siç edhe pritej, Trojka ia dorëzoi një raport Sekretarit të Përgjithshëm të KB, ku thuhej se Kosova dhe Serbia nuk ishin në gjendje ta arrinin një marrëveshje për statusin përfundimtar të Kosovës.<sup>34</sup> Lidhur me këtë duhet të sqarohet se Rezoluta 1244 e KS KB nuk e bënte të detyrueshme që statusi final i Kosovës duhej të miratohej nga Këshilli i Sigurimit.

Pasi i shteroi të gjitha rrugët diplomatike, në koordinim me Brukselin dhe Washingtonin, Kosova shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008. Ashtu siç edhe pritej, Moska reagoi me armiqësi të madhe, dhe Putini këtë e etiketoi si një “precedent të tmerrshëm” i cili “do të kthehej për ta goditur Perëndimin në fytyrë.”<sup>35</sup> Rusia dhe Serbia u përballën me edhe një zmbropsje kur nisma e tyre e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e KB në tetor 2008,<sup>36</sup> për t’ia referuar legalitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) nuk lëvizi në favor të tyre. Rusia ia prezantoi Gjykatës një deklaratë më të gjatë që e shprehte pikëpamjen dhe argumentet e saj pse shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës nuk ishte në pajtim me

---

<sup>32</sup> Luke Hardin, Russia threatening new cold war over missile defence, The Guardian, 11 prill, 2007, Në dispozicion në: <https://www.theguardian.com/world/2007/apr/11/usa.topstories3>.

<sup>33</sup> Andrew Rettman, Russia confirms veto on Kosovo’s independence, Euobserver, 27 prill, 2007, Në dispozicion në: <https://euobserver.com/world/23933>.

<sup>34</sup> UNSC, S/2007/723, Letter dated 10 December 2007 from the Secretary-General to the President of the Security Council, Në dispozicion në: <https://reliefweb.int/report/serbia/un-sgs-letter-dated-10-dec-2007-president-un-sc-report-euusrussian-fed-troika-kosovo>.

<sup>35</sup> The Sydney Morning Herald, Putin calls Kosovo independence ‘terrible precedent,’ 23 shkurt, 2008, Në dispozicion në: <https://www.smh.com.au/world/putin-calls-kosovo-independence-terrible-precedent-20080223-gds2d5.html>.

<sup>36</sup> UNGA, A/Res/63/3, 8 tetor, 2008, Në dispozicion në: <https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kos%20A%20RES63%203.pdf>.

të drejtën ndërkombëtare.<sup>37</sup> Mirëpo Opinioni Këshillues i GjND-së, i dhënë më 22 korrik 2010, në mënyrë të qartë e pohonte se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk e shkelte të drejtën ndërkombëtare.<sup>38</sup> Më pas, Rezoluta [A/RES/64/292] e Asamblesë së Përgjithshme të KB e miratuar më 9 shtator 2010, e cila u përkrah po ashtu edhe nga Rusia, e pranoi përmbajtjen e Opinioni Këshillues të GjND-së, dhe mandatin e KB lidhur me mosmarrëveshjen Kosovë–Serbi ia barti Bashkimit Evropian.<sup>39</sup>

Me këtë, Rusia faktikisht mbeti jashtë tryezës së bisedimeve midis Kosovës dhe Serbisë, e cila u bart nën ombrellën e BE-së. Megjithatë, ngjarjet e më pastajme tregojnë se ndikimi i Moskës në dialogun Kosovë-Serbi nuk është shmangur. Përçarjet e brendshme brenda Bashkimit Evropian ia kanë dhënë Kremlinit një mundësi për ta mbështetur dhe avancuar agjendën e vet. Kjo e nënkupton edhe forcimin e ndikimit të saj mbi Serbinë, e cila është bastioni kryesor i interesave ruse në Ballkanin Perëndimor. Pjesët në vijim të këtij punimi e ofrojnë një analizë gjithëpërfshirëse të rolit dhe interesit të Federatës Ruse në fazën e re të dialogut Kosovë-Serbi, të ndihmuar nga BE-ja.

## **II. Ndërhyrja e Ruisë në dialogun e ndihmuar nga BE-ja**

Lëvizja e parë e Ruisë pas miratimit të Rezolutës 64/298 të Asamblesë së Përgjithshme të KB ishte një përpjekje për t’ia rrënuar themelet mandatit të BE-së në lehtësimin e dialogut midis Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve të tyre, si dhe Opinioni Këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Në një deklaratë të lëshuar nga Ministria e Jashtme ruse një ditë pas miratimit të rezolutës së KB, më 10 shtator 2010,<sup>40</sup> roli i BE-së për ta ndihmuar

---

<sup>37</sup> Pohimi rus u argumentua në disa baza: Rezoluta 1244 e thekson integritetin territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë, duke krijuar një supozim në favor të integritetit territorial; Rezoluta nuk përjashtonte mundësinë e pavarësisë por kërkon që ajo të jetë rezultat i marrëveshjes së negociuar apo vendimit të Këshillit të Sigurimit, duke i përjashtuar veprimet e njëanshme; Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, të themeluara sipas Rezolutës 1244, u mungonte kompetenca për shpalljen e pavarësisë. Për më tepër, pohimi rus e mbronte qëndrimin që sipas të drejtës ndërkombëtare, secesioni lejohet vetëm në rastet e skajshme të dhunës mizore, e cila nuk vlente për Kosovën në vitin 2008. Written Statement of the Russian Federation, 16 shkurt, 2009, Në dispozicion në: <https://www.icj-cij.org/sites/default/files/case-related/141/15628.pdf>.

<sup>38</sup> ICJ, Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect to Kosovo, 22 korrik, 2010. Në dispozicion në: <https://www.icj-cij.org/public/files/case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf>.

<sup>39</sup> United Nations, General Assembly Resolution 64/298, 9 shtator 2010, Në dispozicion në: <https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/ROL%20A%20RES64%20298.pdf>

<sup>40</sup> Russian MFA Information and Press Department Comment in Relation to the Adoption by UN General Assembly of a Resolution on the International Court of Justice Advisory Opinion on Kosovo, 19 shtator 2010, Në dispozicion në: [https://www.mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1597928/](https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1597928/).

procesin e dialogut nuk është përmendur fare. Në vend të kësaj, deklarimi e theksonte që “Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të KB mbetet baza ligjore për një zgjidhje afatgjate, të qëndrueshme, të problemit të Kosovës.” Po ashtu pohohet se “Misioni në Kosovë i KB është që ai të vazhdojë të luaj një rol të rëndësishëm në ndihmën e këtij procesi në bazë të mandatit të tij të marrë nga Këshilli i Sigurimit të KB,” edhe pse, deri në atë kohë, Misioni i KB tashmë ia kishte dorëzuar të gjitha kompetencat e veta ekzekutive autoriteteve kosovare dhe Misionit për Sundimin e Ligjit të BE-së (EULEX). Një muaj pasi që dialogu i ndihmuar nga BE-ja filloi në Brussels, më 8 mars 2011, Ministri i Jashtëm Rus Lavrov, gjatë vizitës së tij në Beograd më 19 prill 2011, e ri-përsëriti përkrahjen për qëndrimin e Serbisë. Ai më tutje e theksoi rëndësinë e ruajtjes së rolit të UNMIK-ut nën të njëjtat kushte si edhe para shpalljes së pavarësisë së Kosovës.<sup>41</sup> Ngjashëm, me qëllim të rrënimit të themeleve të rolit ndihmës të BE-së, në nëntorin 2011 Lavrovi deklaroi se Rusia e thekson nevojën urgjente për ta ruajtur rolin e KB dhe të Këshillit të tyre të Sigurimit në procesin negociator.<sup>42</sup>

Në këtë sfond, një nga momentet më të rëndësishme në dialog ndodhi në prill 2013, kur Kosova dhe Serbia në Bruksel e arritën Marrëveshjen e Parë mbi Parimet që e Drejtojnë Normalizimin e Marrëdhënieve.<sup>43</sup> Kjo marrëveshje e shtroi themelin për një “*modus vivendi*” midis dy vendeve, por nuk e zgjodhi mosmarrëveshjen e tyre. Mirëpo, vetëm një muaj pas marrëveshjes, më 24 maj, 2013, Presidenti i Serbisë, Nikoliq, e nënshkroi Deklaratën për Partneritetin Strategjik me Putinin, duke sinjalizuar kështu një zhvendosje të rëndësishme në rreshtimin e Beogradit drejt Moskës. Me këtë rast, ai deklaroi se një “epokë e re” në bashkëpunim ishte para Rusisë dhe Serbisë, duke e theksuar se asnjë qëllim nuk është i paarritshëm kur të dyja vendet punojnë bashkë.<sup>44</sup> Në anën tjetër, gjatë takimit të 27–28 qershorit 2013, Këshilli Evropian e arriti konsensusin për të filluar negociatat e aksesionit me Serbinë deri në janarin 2014.<sup>45</sup> Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) me Kosovën është negociuar me Kosovën midis

---

<sup>41</sup> MPJ ruse, Transcript of Remarks and Replies by Russian Foreign Minister Sergey Lavrov to Media Questions at Joint Press Conference Following Talks with Serbian Foreign Minister Vuk Jeremić, Beograd, 19 prill, 2011, Në dispozicion në: [https://www.mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1701838/](https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1701838/)

<sup>42</sup> MPJ ruse, Russian Foreign Minister Sergey Lavrov interview to the Serbian Newspaper Večernje Novosti, 1 nëntor, 2011, Në dispozicion në: [https://mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1622784/](https://mid.ru/en/foreign_policy/news/1622784/) .

<sup>43</sup> First Agreement on Principles Governing the Normalization of Relations, 19 prill 2013, Në dispozicion në: <https://www.peaceagreements.org/viewmasterdocument/2022> .

<sup>44</sup> B92, Nikolić, Putin sign Strategic Partnership Declaration, 24 maj, 2013, Në dispozicion në: [https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2013&mm=05&dd=24&nav\\_id=86333](https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2013&mm=05&dd=24&nav_id=86333)

<sup>45</sup> Këshilli Evropian, Serbia, Në dispozicion në: <https://www.consilium.europa.eu/en/policies/enlargement/serbia/> .

tetorit 2013 dhe majit 2014, e inicializuar në korrik 2014, dhe Këshilli i BE-së e aprovoi nënshkrimin e saj më 22 tetor 2015.<sup>46</sup>

Në këtë kontekst, Rusia e ka pozicionuar veten strategjikisht që ta ndikojë dialogun në mënyrë të tërthortë, duke e motivuar Serbinë për t'u përmbajtur nga ndërmarrja e hapave guximtarë drejt normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën. Kjo u dëshmuar në mënyrë të përshtatshme gjatë vizitës së Ministrit të Jashtëm rus Lavrov në Beograd, më 16 qershor 2013, dy muaj pas Marrëveshjes së Parë për Normalizimin e Marrëdhënieve. Me këtë rast, Kryeministri i atëhershëm i Serbisë, Ivica Dačić, deklaroi me entuziazëm se “marrëdhëniet me Rusinë janë në nivelin mbase më të lartë në dy dekadat e fundit” dhe pohoi se “pa mbështetjen e Ruisë dhe të Kinës në KS KB, qëndrimi i Serbisë për “Kosovën e Metohinë” sot do të ishte i pashpresë.”<sup>47</sup> Kështu, duke ia ofruar Beogradit para kohe këtë karotë – domethënë, hapjen e bisedimeve për anëtarësim – BE-ja e humbi ndjeshëm ndikimin mbi Serbinë. Kjo Serbisë ia krijoi mundësinë për t'u afruar më shumë me Rusinë pa u përballur me ndonjë pasojë të rëndësishme në rrugëtimin e saj drejt integritetit në BE, dhe duke përfituar ndihmën përkatëse financiare nga BE-ja, në total 1.1 miliardë euro në vit.<sup>48</sup>

Kjo politikë “edhe BE-ja, edhe Rusia” e Serbisë u trajtësua edhe më tutje kur Rusia e pushtoi Krimenë në vitin 2014. Serbia deklarativisht e përkrahu integritetin territorial të Ukrainës, por u përmbajt nga ajo që t'i bashkëngjitej sanksioneve Perëndimore kundër Ruisë, duke synuar shmangien e rrezikimit të marrëdhënieve të mira me Moskën. Kjo ilustron nga dilema e stilit hamletian e Zëvendëskryeministrit të atëhershëm, Vučić, i cili më 22 mars 2014 pohonte “A doni nga ne që të fusim sanksione kundër Ruisë, që të deklarojmë se e përkrahim shkeljen e integritetit tonë territorial, e me të cilën do ta humbim Kosovën, apo t'ia kthejmë shpinën BE-së?”<sup>49</sup> Rrjedhimisht, Serbia u përmbajt nga ajo që të rreshtohet me deklaratimet e shumta për Ukrainën të bëra nga BE-ja pas shpërthimit të luftës në Ukrainë. Kjo po ashtu nuk mori pjesë në nismat e ndërmarrja nga shtetet anëtare të BE-së në OSBE. Pos kësaj, kur pyeteshin për

---

<sup>46</sup> Këshilli Evropian, Njoftim për shtyp, Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim (SAA) midis Bashkimit Evropian dhe Kosovës, e nënshkruar më 27 tetor 2015. Në dispozicion në: <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/10/27/kosovo-eu-stabilisation-association-agreement/>.

<sup>47</sup> Bodo Weber, B. dhe Kurt Bassuener, The Western Balkans and Ukrainian Crisis, a changed game for EU and US policies, Punim Politikash, Democratization Policy Council, Berlin – Sarajevo, 2014, fq. 3.

<sup>48</sup> Mateja Agatonović, How much money Serbia receives from the EU and how much it risks to lose?, European Western Balkans, 12 dhjetor, 2022, Në dispozicion në: <https://europeanwesternbalkans.com/2022/12/14/how-much-money-serbia-receives-from-the-eu-an-how-much-it-risks-to-lose/>

<sup>49</sup> Blic, Vučić: Srbija neće imati neprijateljski stav prema Rusiji, 22 mars 2013, Në dispozicion në: <https://www.blic.rs/vesti/politika/vucic-srbija-neece-imati-neprijateljski-stav-prema-rusiji/22400e5>

Kapitullin 31 të negociatave të aksesionit (për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë – CFSP), Ministri i Jashtëm Dačić dhe përfaqësuesit e tjerë serbë e theksonin se harmonizimi i plotë kërkohet vetëm rreth përfundimit të procesit të aksesionit.<sup>50</sup>

Është interesante që BE-ja nuk e ka sanksionuar këtë politikë të Serbisë, edhe përkundrejt rreshtimit të saj të qartë me Rusinë. Ky rreshtim Moskës ia ka dhënë një mundësi të ndikimit të tërthortë shtesë në dialogun Kosovë–Serbi të ndihmuar nga BE-ja. Duke pasur parasysh që Kremli e ka keqpërdorur shpalljen e pavarësisë së Kosovës për ta përlligjur aneksimin e paligjshëm të Krimesë,<sup>51</sup> Moska i ka përfshirë qartë përfundimet e dialogut në një kalkulim më të gjerë të interesave ruse në të jashtmen e vet të afërt, duke llogaritur në rreshtimin e Serbisë, që rrjedhimisht do ta rriste potencialin destabilizues në Ballkan. Prirja e Beogradit për t'i dhënë prioritet përkrahjes nga Rusia në raport me përpjekjet e Perëndimit për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet me Kosovën është bërë e qartë. Për më tepër, Beogradi veten e kishte pozicionuar si një fortesë e interesave ruse në Ballkan, posaçërisht në kohën kur rajoni perceptohet nga Moska si “hallka më e dobët e Evropës.”<sup>52</sup>

Më 25 gusht 2015, Kosova dhe Serbia e arritën një përparim tjetër në dialogun e ndihmuar nga BD-ja, duke u pajtuar me Parimet e Përgjithshme për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.<sup>53</sup> Mirëpo, themelimi i Asociacionit u ndal me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, më 23 dhjetor 2015, e cila përfundoi se disa dispozita që i saktësonin rolin dhe kompetencat e Asociacionit nuk i plotësonin në tërësi standardet kushtetuese, dhe se kërkonin përshtatje të caktuara.<sup>54</sup> Për më tepër, në vitet në vijim, Kosova u përball me jo stabilitet politik që zgjati deri më 2021, duke i përjetuar pesë ndërrime të qeverive, para së gjithash si pasojë e procesit sfidues të bisedimeve me Serbinë.

---

<sup>50</sup> Bodo Weber, B. dhe Kurt Bassuener, *The Western Balkans and Ukrainian Crisis, a changed game for EU and US policies*, Punim Politikash, Democratization Policy Council, Berlin – Sarajevo 2014, fq. 7.

<sup>51</sup> Kremlin, Fjala nga Presidenti i Federatës Ruse, 18 mars 2014. Në dispozicion në: <http://en.kremlin.ru/events/president/news/20603>.

<sup>52</sup> Janusz Bugajski dhe Margarita Assenova, *Eurasian Disunion: Russia's Vulnerable Flanks*, The Jamestown Foundation, Washington D.C., 2016, fq. 219.

<sup>53</sup> European External Action Service, *Association/Community/of/ Serb/majority/municipalities/in/Kosovo/–/general/principles/main/elements*, 25 gusht 2015, Në dispozicion në: [https://eeas.europa.eu/archives/docs/statements-eeas/docs/150825\\_02\\_association-community-of-serb-majority-municipalities-in-kosovo-general-principles-main-elements\\_en.pdf](https://eeas.europa.eu/archives/docs/statements-eeas/docs/150825_02_association-community-of-serb-majority-municipalities-in-kosovo-general-principles-main-elements_en.pdf).

<sup>54</sup> Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Rasti numër KO 130/15, “Asociacioni/Komuniteti i Komunave me shumicë serbe në Kosovë, parimet e përgjithshme/elementet kryesore” me frymën e Kushtetutës, Neni 2 [Barazia Para Ligjit], paragrafi 1, Kapitulli II [Të Drejtat dhe Liritë Kryesore] dhe Kapitulli III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe të Anëtarëve të Tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,” 23 dhjetor 2015, Në dispozicion në: [https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk\\_ko\\_130\\_15\\_ang.pdf](https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ko_130_15_ang.pdf).

Këto rrethana i dhanë Rosisë mundësi që BE-në ta përshkruante si një ndërmjetës të anshëm, ndërkohë që Kosovën e akuzonte për shmangien e themelimit të Asociacionit. Në një deklaratë në vijim të vizitës së Ministrit të Jashtëm Serb Ivica Dačić në Moskë, më 1 prill 2016, Ministri i Jashtëm Rus Lavrov fillimisht e theksoi vlerësimin e lartë të Rosisë për qëndrimin parimor të Serbisë përballë përpjekjeve të mbështetura nga BE-ja për të imponuar sanksione kundër Rosisë nga vendet jashtë BE-së. Pos kësaj, ai pohoi pa kurrfarë baze se të drejtat e popullit serb në Kosovë shkelen në mënyrë të vazhdueshme, dhe se marrëveshjet midis Beogradit e Prishtinës, të përkrahura nga BE-ja, dhe posaçërisht lidhur me krijimin e “bashkësisë të komunave serbe” në Kosovë, i nënshtrohen një sabotimi të vazhdueshëm. Moska e shprehu shqetësimin për mungesën e “një përgjigjeje vendimtare” nga ana e Brukselit ndaj këtyre çështjeve, dhe e thirri “BE-në që ta ruante reputacionin e vet si një ndërmjetës i paanshëm,” duke siguruar që Kosova t’i përmbushte përkushtimet e veta.<sup>55</sup> Ky qëndrim u përsërit sërish në deklaratimet e Presidentit Putin, Ministrit të Jashtëm Lavrov, Zëvendës Ministrit Meshkov, Përfaqësuesit të Përhershëm të Federatës Ruse në OSBE, Alexander Lukashevich, dhe Zëdhënësës së MPJ Zakharova, gjatë gjithë kohës në vitet 2016 dhe 2017.<sup>56</sup>

Pasojat e kësaj aleance ruso-serbe kundër Kosovës dhe përpjekjet për t’i rrënuar themelet e veprimeve lehtësuese të BE-së u bënë të qarta. Kështu, më 27 tetor 2017, Surinami shpalli tërheqjen e njohjes së pavarësisë së Kosovës,<sup>57</sup> që thuhet se u bë për ta kënaqur Putinin para vizitës së parë në Rusi të Ministrit të Jashtëm të Surinamit Pollack-Beigh-it, më 31 tetor 2017.<sup>58</sup>

---

<sup>55</sup> MPJ ruse, Foreign Minister Sergey Lavrov’s statement and answers to media questions at a joint news conference following talks with First Deputy Prime Minister and Minister of Foreign Affairs of Serbia Ivica Dačić, Moskë, 1 prill 2016. Në dispozicion në:

[https://www.mid.ru/en/press\\_service/minister\\_speeches/1525371/](https://www.mid.ru/en/press_service/minister_speeches/1525371/).

<sup>56</sup> Shih për shembull: Briefing by Foreign Ministry Spokesperson Maria Zakharova, Moskë, 24 nëntor 2016. Në dispozicion në:

[https://mid.ru/en/press\\_service/spokesman/briefings/1538558/](https://mid.ru/en/press_service/spokesman/briefings/1538558/);

Briefing by Foreign Ministry Spokesperson Maria Zakharova, Moskë, 9 shkurt 2017, Në dispozicion në:

[https://mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1541890/](https://mid.ru/en/foreign_policy/news/1541890/);

Foreign Minister Sergey Lavrov’s remarks and answers to media questions at a news conference following talks with Deputy Prime Minister and Minister of Foreign and European Affairs of Croatia Davor Ivo Stier, Moskë, 23 maj 2017. Në dispozicion në: [https://www.mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1547273/](https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1547273/);

Deputy Foreign Minister Alexey Meshkov’s remarks at the round table, Peace, Stability and Security in Southeastern Europe and the Mediterranean, held as part of the Dubrovnik Forum 2017, Dubrovnik, 1 korrik 2017, Në dispozicion në: [https://www.mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1549321/](https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1549321/);

Permanent Representative of the Russian Federation to the OSCE Alexander Lukashevich’s remarks at a meeting of the OSCE Permanent Council, Vienna, 31 gusht 2017. Në dispozicion në:

[https://mid.ru/en/foreign\\_policy/rso/1551687/](https://mid.ru/en/foreign_policy/rso/1551687/).

<sup>57</sup> Balkan Insider, What did Suriname just do to Kosovo, 31 tetor 2017, Në dispozicion në:

<https://www.balkaninsider.com/what-did-suriname-just-do-to-kosovo/>

<sup>58</sup> Lidia Kos-Stanišić, Đana Luša, “Position of Latin America Towards Kosovo, në Proroković, D. (red.), *Kosovo: Sui generis or Precedent in International Relations*. Beograd: Institute for International Politics and Economics, 2018, fq. 254.



Kjo lëvizje është paraprirë nga vizita e delegacionit rus të biznesit në Surinam në të njëjtin muaj dhe vizita e Ministrit të Tregtisë së Surinamit në Shën Petersburg, në maj të të njëjtit vit.<sup>59</sup> Gjatë vitit të ardhshëm, nëntë vende të tjera e tërhoqën njohjen e Kosovës.<sup>60</sup> Pasi që Surinami e tërhoqi njohjen e Kosovës, Presidenti Vučić i Serbisë e vizitoi Moskën më 19 dhjetor 2017, në të cilin rast Presidenti Putin e shprehu përkrahjen për “sovrانيتin dhe integritetin territorial” të Serbisë.<sup>61</sup> Kjo u rreshtua krahas përpjekjeve për çnjohjen e Kosovës, me Ambasadorin e Rusisë në KB, Nebenzia, duke i akuzuar “promotorët dhe ekzekutuesit e projektit të Kosovës” dhe duke thirrur për reflektim lidhur me rezultatet e tij, ndërkohë që e akuzonte BE-në për dështimin në lehtësimin e dialogut.<sup>62</sup> Në qershor 2018, Putini e shfrytëzoi përsëri “precedentin e Kosovës” për ta përligjur aneksimin e Krimesë, duke pretenduar që pavarësia e Kosovës ishte një aneksim përmes pushtimit të NATO-s.<sup>63</sup> Kremlini, përmes kësaj lufte hibride e shfrytëzoi në mënyrë strategjike intervenimin e NATO-s të vitit 1999 dhe pavarësinë e Kosovës, duke i shfrytëzuar ato për t’i çuar përpara ambicjet hegjemone të Rusisë në rajonet fqinje.

Në vend të lëvizjes përpara në procesin e normalizimit, këto veprime të aleancës Serbi–Rusi punuan për bllokim të negociatave, duke i nxitur palët, njësoj si edhe udhëheqësen e politikës së jashtme dhe ndërmjetësen e dialogut Kosovë–Serbi, Federica Mogherinin,<sup>64</sup> si dhe disa vende të BE-së,<sup>65</sup> për ta shqyrtuar mundësinë e një shkëmbimi territorial midis Kosovës dhe Serbisë. Ky propozim hasi në rezistencë nga vendet e tjera anëtare,<sup>66</sup> duke i thelluar ndarjet

---

<sup>59</sup> The Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation, Foreign Minister Sergey Lavrov’s remarks and answers to media questions at a joint news conference following talks with Surinamese Foreign Minister Yldiz Pollack-Beighle, Moskë, 31 tetor 2017. Në dispozicion në:

[https://www.mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1556116/](https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1556116/).

<sup>60</sup> European Parliament, Parliamentary Questions, Subject: VP/HR — Withdrawal of recognition of Kosovo, 20 dhjetor 2018. Në dispozicion në: [https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/E-8-2018-006438\\_EN.html](https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/E-8-2018-006438_EN.html).

<sup>61</sup> Kremlin, Press Statements following the Russian–Serbian Talks, 19 dhjetor 2017. Në dispozicion në:

<http://en.kremlin.ru/catalog/persons/511/events/56418>.

<sup>62</sup> UNSC Meeting Transcript, Speech by Vladimir A. Nebenzi, Permanent Representative of Russia to the UN at the UN Security Council meeting on the situation in Kosovo, 7 shkurt 2018. Në dispozicion në:

<https://russiaun.ru/en/news/kos070218>.

<sup>63</sup> The Kremlin, Interview with Austrian ORF television channel, 4 qershor 2018. Në dispozicion në:

<http://en.kremlin.ru/events/president/news/57675>.

<sup>64</sup> Jacopo Barigazzi, Mogherini defends Kosovo border change talks, Politico, 31 gusht 2019. Në dispozicion në: <https://www.politico.eu/article/federica-mogherini-kosovo-serbia-defends-border-change-talks/>.

<sup>65</sup> Shih për shembull: Die Morina, Austria ‘Will Not Oppose’ Kosovo–Serbia Border Changes, BalkanInsight, 6, nëntor 2018. Në dispozicion në: <https://balkaninsight.com/2018/11/06/austria-supports-border-correction-between-kosovo-and-serbia-11-06-2018/>.

Në dispozicion në: Die Morina, Kosovo President Claims Macron Supports Border Correction, Në dispozicion në: <https://balkaninsight.com/2018/10/12/macron-supports-border-correction-with-serbia-kosovo-president-says-10-12-2018/>.

<sup>66</sup> Shih për shembull: Andre Gray, Angela Merkel: No Balkan border changes, Politico, 13 gusht 2018. Në dispozicion në: <https://www.politico.eu/article/angela-merkel-no-balkan-border-changes-kosovo-serbia-vucic-thaci/>;

përbrenda Bashkimit Evropian dhe duke e fuqizuar edhe më tutje bllokimin ekzistues të procesit të dialogut, krahas qëndrimit të pesë vendeve mos-njohëse. Nga ana tjetër, opsioni i shkëmbimit të territoreve midis Kosovës e Serbisë ka mundur t'i shkojë për shtati kalkulimeve gjeopolitike ruse në rajonet e saj të afërta, dhe posaçërisht lidhur me Osetinë Jugore, Abkhazinë, Krimenë, Donetskun dhe Luhanskun. Nuk është e rastësishme se ajo që është dukur e papërfytyrueshme u bë realitet kur Presidenti Putin dhe Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi u takuan shkurtimisht në Paris në Përkujtimin e Armëpushimit, më 12 nëntor 2018. Sipas Thaçit, qëndrimi i Putinit ishte i qartë: “Nëse arrini një marrëveshje paqësore, Rusia do ta përkrahë atë.”<sup>67</sup> Ngjashëm, një deklaratë e Kremlinit e lëshuar më 14 nëntor 2018 thoshte që Putini “ia bëri me dije Thaçit se Prishtina duhet ta arrijë një konsensus me Beogradin, dhe i tha se Rusia do ta përkrahë një vendim të përbashkët nga Beogradi dhe Prishtina.”<sup>68</sup>

Në këtë sfond, ambasadori rus në Serbi, Alexander Botsan-Kharchenko, e sqaroi më tutje qëndrimin e Ruisë në një intervistë me të përditshmen serbe *Politika*, më 1 shtator 2019,<sup>69</sup> në mes të një zbrapsjeje të konsiderueshme të propozimit për shkëmbimin e territoreve. Në këtë intervistë ai pohoi se “Serbia është një fortesë e Ruisë, dhe, po ashtu, edhe Rusia është një fortesë e Serbisë, dhe edhe do të mbetet e tillë.” Në këtë vazhdë, ai theksoi se Perëndimi synon ta largojë Rusinë nga Ballkani, ashtu që të gjitha vendet e rajonit të anëtarësohen në NATO. Edhe pse e nënvizoi se Rusia nuk e mbështet në mënyrë eksplicite ndarjen e Kosovës, Kharchenko përmendi se një ndarje e tillë nuk do ta krijonte “ndonjë precedent për ndarjen territoriale në Evropë,” duke e shprehur kështu preferencën që Moska e ka për këtë opsion që padyshim i shërben ambicieve të saj hegjemoniste në fqinjësinë e saj të afërt.

Sidoqoftë, mandati i shefes së politikës së jashtme të BE-së, Mogherini përfundoi më 30 nëntor 2019, duke shënuar trashëgiminë e saj në dialogun Kosovë–Serbi me marrëveshjen fillestare për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe dhe me përkrahjen e më pastajme për bisedimet për shkëmbimin e territoreve, një lëvizje kjo që është në konflikt me konceptin e Asociacionit. Mungesa e kohezionit dhe e lidhshërisht brenda BE-së, e kombinuar me jo

---

Robin Emmott, EU warns against Serbia–Kosovo land swap idea, Reuters, 31 gusht 2018, transmetuar nga Euronews. Në dispozicion në: <https://www.euronews.com/2018/08/31/eu-warns-against-serbia-kosovo-land-swap-idea>

<sup>67</sup> Dia Morina, Putin will Back Kosovo-Serbia Deal, Thaçi Insists, 12 nëntor 2019, Balkan Insight, Në dispozicion në: <https://balkaninsight.com/2018/11/12/kosovo-s-thaci-putin-supports-an-agreement-between-kosovo-and-serbia-11-12-2018/>.

<sup>68</sup> B92, Kremlin discloses what Putin told Thaçi, 14 nëntor 2018. Në dispozicion në: [https://www.b92.net/eng/news/world.php?yyyy=2018&mm=11&dd=14&nav\\_id=105518](https://www.b92.net/eng/news/world.php?yyyy=2018&mm=11&dd=14&nav_id=105518).

<sup>69</sup> Intervistë e Ambasadorit të Ruisë në Serbi, A. A. Botsan-Kharchenko, gazetës *Politika*, 1 shtator 2019, Në dispozicion në: [https://serbia.mid.ru/ru/press-centre/news/intervyu\\_a\\_a\\_botsan\\_kharchenko\\_gazete\\_politika/](https://serbia.mid.ru/ru/press-centre/news/intervyu_a_a_botsan_kharchenko_gazete_politika/).

stabilitetin dhe ndarjet politike në Kosovë, e shndërruan këtë mandat në një mundësi të humbur për normalizimin e marrëdhënieve midis Prishtinës dhe Beogradit. Kjo po ashtu çoi në një aleancë edhe më të fuqishme të Serbisë me Rusinë, duke i përjetësuar tendosjet në rajon që i shërbejnë vetëm interesave të Kremlinit.

Kur Miroslav Lajčák e mori rolin e Përfaqësuesit të ri Special të BE-së për dialogun Kosovë–Serbi, në prillin e vitit 2020, propozimi për shkëmbimin e territoreve pothuaj se ishte hequr fare nga tavolina. Lajčáku e pohoi në mënyrë të qartë në fillimin e mandatit të tij, në maj 2020, se opsioni i shkëmbimit të territoreve nuk është në konsideratë, dhe se ai është kundër të drejtës ndërkombëtare dhe stabilitetit rajonal.<sup>70</sup> Mirëpo, Serbia dhe Rusia nuk kishin hequr dorë nga ky opsion i cili i bashkonte ambiciet e tyre hegjemone. Në artikullin e tyre të përbashkët të titulluar “The Kosovo Knot: Is a Fair Solution Possible?” të botuar më 18 qershor 2020 në Rossiyskaya Gazeta dhe Kurir, Lavrovi dhe Dačići i konfirmuan qëndrimet e tyre të bashkuara, përfshirë edhe qëndrimet e përbashkëta për Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian. Ata i kritikonin evropianet për kundërshtimin e propozimit për shkëmbimin e territoreve dhe e përsërisnin që vendimi final duhet të miratohet nga Këshilli i Sigurimit i KB dhe që Moska do ta pranojë vetëm një marrëveshje me të cilën pajtohet Beogradi.<sup>71</sup>

Nga ana tjetër, më 19 qershor 2020, i dërguari special i SHBA-ve për dialogun Kosovë – Serbi, Richard Grenell, e hodhi poshtë idenë që shkëmbimi i territoreve midis Kosovës dhe Serbisë ishte pjesë e politikës së Presidentit Trump. Ai po ashtu e shpalli “marrëveshjen historike” midis Kosovës e Serbisë, që pritej për 27 qershor 2020 në Shtëpinë e Bardhë, të parë si një hap paraprak drejt marrëveshjes potenciale përfundimtare të ndihmuar nga Bashkimi Evropian.<sup>72</sup> Mirëpo, takimi nuk ndodhi si u planifikua për shkak të aktakuzës së Dhomave të Specializuara ndaj Presidentit të Kosovës Hashim Thaçit kur ishte në rrugë për në Washington. Marrëveshja

---

<sup>70</sup> GazetaExpress, EU’s envoy on Dialogue oppose Kosovo–Serbia land swap, 11 maj 2020, Në dispozicion në: <https://www.gazetaexpress.com/eus-envoy-on-dialogue-oppose-kosovo-serbia-land-swap/>.

<sup>71</sup> Ministria e Jashtme Ruse: Artikull i shkruar bashkarisht nga Ministri i Jashtëm Sergey Lavrov dhe Zëvendës Kryeministri i Parë dhe Ministri i Jashtëm i Republikës së Serbisë Ivica Dačić i botuar në Rossiyskaya Gazeta dhe Kuririn serb, 18 qershor 2020. Në dispozicion në: [https://www.mid.ru/en/web/guest/maps/us/-/asset\\_publisher/unVXBbj4Z6e8/content/id/416827](https://www.mid.ru/en/web/guest/maps/us/-/asset_publisher/unVXBbj4Z6e8/content/id/416827).

<sup>72</sup> Victoria Garcia, Grenell trashes Bolton, claims ex-security adviser ‘saved salacious stories in order to sell books,’ Fox News, 19 qershor 2020, Në dispozicion në: <https://www.foxnews.com/media/grenell-bolton-saved-salacious-stories-sell-books>.

e Washingtonit u nënshkrua më vonë nga Kryeministri Hoti dhe Presidenti serb Vučić, më 4 shtator 2020.<sup>73</sup>

Mirëpo, pas takimit të Washingtonit me kërkesën e Vučićit, u bë një bisedë telefonike fillestare me Lavrovin, më 6 shtator 2020. Gjatë bisedës lidhur me sinkronizimin e politikës për Kosovën, u theksua vetëm qëndrimi rus që e përkrahte marrëveshjen në pajtim me (interpretimin rus) të Rezolutës 1244.<sup>74</sup> Nga ana tjetër, deklarata të cilën e lëshoi Kremli pas bisedës telefonike të Vučićit me Putinin më 10 shtator 2020, e theksoi domosdoshmërinë e “zgjidhjes së balancuar kompromise” e cila do të ishte e pranueshme për Beogradin dhe e miratuar nga Këshilli i Sigurisë së KB.<sup>75</sup>

Pas largimit të opsionit të shkëmbimit të territoreve, edhe nga Brukseli, edhe nga Washingtoni, Rusia e përshkallëzoi luftën e vet diplomatike duke e vënë në pyetje kredibilitetin e BE-së si ndërmjetës, dhe ngulmuar në themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, duke theksuar se çdo marrëveshje duhet të jetë e pranueshme për Serbinë dhe, rrjedhimisht, e miratuar nga Këshilli i Sigurisë së KB.<sup>76</sup> Përndryshe, në një artikull tejet shqetësues të Putinit “On the Historical Unity of Russians and Ukrainians,” të botuar më 12 korrik 2021, ai i vuri

---

<sup>73</sup> Shih për shembull: The Washington Post, Serbia and Kosovo sign breakthrough economic accord that is short of normal relations, 4 shtator 2020, Në dispozicion në: [https://www.washingtonpost.com/politics/trump-kosovo-serbia-agreement/2020/09/04/b1283f8c-ee0-11ea-99a1-71343d03bc29\\_story.html](https://www.washingtonpost.com/politics/trump-kosovo-serbia-agreement/2020/09/04/b1283f8c-ee0-11ea-99a1-71343d03bc29_story.html).

<sup>74</sup> Ambasada Ruse në Beograd, Bisedë telefonike midis Ministrit të Jashtëm Rus Sergey Lavrov dhe Presidentit të Serbisë Aleksandar Vučić, 6 shtator 2020. Në dispozicion në: [https://serbia.mid.ru/ru/press-centre/news/o\\_telefonnom\\_razgovore\\_ministra\\_inostrannykh\\_del\\_rossii\\_s\\_v\\_lavrova\\_s\\_prezidentom\\_serbii\\_a\\_vuchichem/](https://serbia.mid.ru/ru/press-centre/news/o_telefonnom_razgovore_ministra_inostrannykh_del_rossii_s_v_lavrova_s_prezidentom_serbii_a_vuchichem/).

<sup>75</sup> Kremli, Bisedë telefonike me Presidentin e Serbisë Aleksandar Vučić, 10 shtator 2020. Në dispozicion në: <http://en.kremlin.ru/catalog/persons/511/events/64019>.

<sup>76</sup> Shih për shembull: MPJ Ruse, Përgjigja e Zëvendës Ministrit të Jashtëm Alexander Grushko në një pyetje të medias për rezultatit e raundit të dialogut të ekspertëve Beograd–Prishtinë, 22 shtator 2020. Në dispozicion në: [https://mid.ru/en/foreign\\_policy/rso/evropejskij-souz-es/1442578/](https://mid.ru/en/foreign_policy/rso/evropejskij-souz-es/1442578/);

Vërejtjet hyrëse të Ministrit të Jashtëm Sergey Lavrov në konferencën e përbashkët për shtyp pas bisedimeve me Ministrin e Jashtëm të Republikës së Serbisë Nikola Selaković, Beograd, 15 dhjetor 2020. Në dispozicion në: [https://www.mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1449583/](https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1449583/);

Deklarata e Ministrit të Jashtëm Sergey Lavrov dhe përgjigjet e tij në pyetjet e mediave në konferencën e përbashkët për shtyp me Ministrin e Jashtëm të Republikës së Serbisë, Nikola Selaković, Moskë, 16 prill 2021. Në dispozicion në: [https://www.mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1419942/](https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1419942/);

Deklaratë nga Zëvendës Përfaqësuesi i Parë i Përhershëm, Dmitry Polyanskiy në njoftimin për shtyp për bashkëpunimin midis KB dhe organizatave rajonale, 1 qershor 2021. Në dispozicion në:

[Permanent Mission of the Russian Federation to the United Nations \(russiaun.ru\)](https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1419942/);

Informim nga Zëdhënësjja e Ministrisë së Jashtme, Maria Zakharova, Moskë, 10 qershor 2021. Në dispozicion në: [Briefing by Foreign Ministry Spokeswoman Maria Zakharova, Moscow, June 10, 2021 - News - The Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation \(mid.ru\)](https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1419942/).

Vërejtjet e Ministrit të Jashtëm Sergey Lavrov dhe përgjigjet e tij në pyetjet e medias në konferencën e përbashkët për shtyp pas bisedimeve me Presidentin e Republikës së Serbisë, Aleksandar Vučić, Beograd, 10 tetor 2021. Në dispozicion në: [https://mid.ru/en/foreign\\_policy/international\\_safety/1783362/](https://mid.ru/en/foreign_policy/international_safety/1783362/).

haptas në dyshim kufijtë e vendeve të tjera që dolën nga ish-Bashkimi Sovjetik,<sup>77</sup> dhe kjo ishte një hyrje në pushtimin rus të Ukrainës, në shkurtin 2022. Në kuadër të këtij konteksti, lufta diplomatike e Moskës lidhur me dialogun Kosovë–Serbi ishte në mënyrë të qartë pjesë e një strategjie më të gjerë që synonte sfidonte Perëndimin dhe kapjen e të gjitha mundësive për manovrimet gjeopolitike në “fqinjësinë e afërt” të Rusisë.

Serbia e përkrahte me besnikëri këtë politikë ruse, ashtu siç tregon shembulli i krizës në veri të Kosovës në shtator 2021. Kur Qeveria e Kosovës vendosi t’i bënte reciprocitet Beogradit me një ndalesë të tabelave të regjistrimit të lëshuara nga Serbia, Ambasadori Rus në Beograd, Alexander Botsan-Kharchenko, i shoqëruar nga Ministri i Mbrojtjes i Serbisë, Stefanović, i inspektoi forcat ushtarake ruse afër kufirit me Kosovën, më 26 shtator 2021, të cilat ishin në gjendje të gatishmërisë së ngritur luftarake. Ai nga aty, në një mënyrë paradoksale, shprehu përkrahjen për përpjekjet e Beogradit për ta de-eskaluar një situatë tejet të rrezikshme,” dhe e akuzoi BE-në dhe SHBA-të për “zbatimin e standardeve të dyfishta dhe për mbylljen e syve ndaj një situatë të cilën ata nuk donin ta kuptonin, përfshirë edhe përcaktimit të fajit për atë që ishte duke ndodhur.”<sup>78</sup>

Në këtë sfond, Kremli e lëshoi një deklaratë të shkurtër hyrëse për takimin midis Presidentit rus Vladimir Putin dhe Presidentit serb Aleksandar Vučić që u mbajt më 25 nëntor 2021 në Sochi, edhe përkundrejt faktit që vetë takimi zgjati rreth tri orë.<sup>79</sup> Sipas TV-së serbe Pink, ashtu siç është cituar nga Radio Evropa e Lirë, Vučići e la takimin duke shprehur krenari në bashkëpunimin ushtarako-teknik me Rusinë. Ai urgjentisht kërkoi arritjen e armëve të veçanta taktike, dhe posaçërisht të armëve anti-tanke, duke e theksuar rëndësinë e tyre për interesat strategjike të Serbisë në të ardhmen e afërt. Vučići aludoi në zhvillimet e afërta, duke thënë se “do të ketë edhe gjëra të tjera shumë të rëndësishme në të ardhmen, dhe atë në një të ardhme jo të largët,” duke shtuar, “kështu ne gjërat e para në Serbi do t’i kemi para fundit të vitit.”<sup>80</sup> Duke i pasur parasysh deklaratat e Vučićit, është e qartë që Presidenti Putin, sipas të gjitha gjasave, e kishte përfshirë edhe grumbullimin e ardhshëm ushtarak rus në kufirin me Ukrainën, dhe koordinimin potencial ruso–serb në Ballkanin Perëndimor, në mes të kanoşjes me pushtim

---

<sup>77</sup> Vladimir Putin, “On the Historical Unity of Russians and Ukrainians”, 12 korrik 2021. Në dispozicion në: <http://en.kremlin.ru/events/president/news/66181>.

<sup>78</sup> Euractiv.rs, Northern Kosovo situation sparks international response, 27 shtator 2021. Në dispozicion në: [https://www.euractiv.com/section/politics/short\\_news/northern-kosovo-situation-sparks-international-response/](https://www.euractiv.com/section/politics/short_news/northern-kosovo-situation-sparks-international-response/).

<sup>79</sup> Kremlin, Talks with President of Serbia of Serbia Aleksandar Vucic, 25 nëntor 2022. Në dispozicion në: <http://en.kremlin.ru/events/president/news/67194>.

<sup>80</sup> Radio Free Europe, Russian, Serbian Presidents Emerge From Meeting With Talk Of Gas Deal, ‘Tactical’ Weapons, 25 nëntor 2021, <https://www.rferl.org/a/putin-vucic-gas-weapons/31579354.html>

të Ukrainës. Me këtë rast duhet vënë në pah se një javë pas takimit të Vučićit me Putinin, mediat në SHBA raportuan për qëllimet ushtarake të Kremlinit ndaj Ukrainës.<sup>81</sup>

Në këtë mënyrë, një zhvillim që ia vlen të vërehet ishte një zhvendosje në narrativet e Moskës që i parapriu sulmit të Moskës kundër Ukrainës. Në dy deklaratat e 13 dhe 14 janarit 2022,<sup>82</sup> Ministri i Jashtëm Lavrov i krahasoi dy rajonet separatiste ruse të mbizotëruara nga rusët, Donetskun dhe Luhanskun, me pjesën veriore të Kosovës të mbizotëruar nga serbët. Ai tërhoqi paralele midis Marrëveshjes së Minskut dhe Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, dhe posaçërisht nga aspekti i të drejtave të popullatave ruse dhe serbe në këto territore përkatëse. Vetëm një ditë pas këtyre deklarimeve, më 15 shkurt 2022, Parlamenti Rus votoi për t'i apeluar Presidentit Putin për njohjen e pavarësisë së rajoneve separatiste të Donetskut dhe Luhanskut.<sup>83</sup> Më pastaj, më 21 shkurt 2022, Putini edhe zyrtarisht e bëri njohjen nga ana e Ruisë të pavarësive të vetë-shpallura të Donetskut dhe Luhanskut,<sup>84</sup> duke i krahasuar ato me pavarësinë e Kosovës.<sup>85</sup> Përfundimisht, më 24 shkurt 2022, Rusia e nisi pushtimin ushtarak të një shkalle të plotë të Ukrainës.

Në këtë kontekst, pas sulmit kundër Ukrainës, Rusia këmbënguli në tërheqjen e paraleleve midis marrëveshjes së Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe të situatës së serbëve të Kosovës, me dispozitat e marrëveshjes së Minskut për Donbasin në Ukrainë dhe rusët në atë rajon, dhe duke e krahasuar pavarësinë e këtyre rajoneve me pavarësinë e Kosovës. Më vonë këto krahasime u zgjeruan për rajonet e Khersonit dhe të Zaporozhyas. Kjo u lidh me përpjekjet për t'ia rrënuar themelet kredibilitetit të ndërmjetësimit perëndimor në dialogun Kosovë–Serbi.<sup>86</sup>

---

<sup>81</sup> Washington Post, Russia planning massive military offensive against Ukraine involving 175,000 troops, U.S. intelligence arns, 3 dhjetor 2021, Në dispozicion në: [https://www.washingtonpost.com/national-security/russia-ukraine-invasion/2021/12/03/98a3760e-546b-11ec-8769-2f4ecdf7a2ad\\_story.html](https://www.washingtonpost.com/national-security/russia-ukraine-invasion/2021/12/03/98a3760e-546b-11ec-8769-2f4ecdf7a2ad_story.html).

<sup>82</sup> Intervista për Channel One “The Great Game” e Ministrit të Jashtëm Sergey Lavrovit, bisedë politike, Moskë, 13 janar 2022. Në dispozicion në: [https://www.mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1794264/](https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1794264/); Vërejtjet e Ministrit të Jashtëm Sergey Lavrov dhe përgjigjet e tij për media në konferencën për shtyp për performansën e politikës së jashtme ruse në vitin 2021, Moskë, 14 janar 2022. Në dispozicion në: [https://www.mid.ru/ru/foreign\\_policy/news/1794396/?lang=en](https://www.mid.ru/ru/foreign_policy/news/1794396/?lang=en).

<sup>83</sup> Anton Zverev dhe Tom Balforth, Russia’s parliament asks Putin to recognise breakaway east Ukrainian regions, 15 shkurt 2022. Reuters, Në dispozicion në: <https://www.reuters.com/world/europe/russias-parliament-asks-putin-recognise-breakaway-east-ukrainian-regions-2022-02-15/>.

<sup>84</sup> BBC, Ukraine: Putin announces Donetsk and Luhansk recognition, 21 shkurt 2022. Në dispozicion në: <https://www.bbc.com/news/av/world-europe-60470900>.

<sup>85</sup> Kremlin, Vladimir Putin answered media questions, Në dispozicion në: <http://en.kremlin.ru/events/president/news/67838>.

<sup>86</sup> Shih për shembull: MPJ Ruse, Deklarimet e Ministrit të Jashtëm Sergey Lavrov dhe përgjigjet e tij në pyetjet e medias në konferencën e përbashkët për shtyp pas bisedimeve me Ministrin e Punëve të Jashtme dhe të

Nga ana tjetër, më 27 shkurt 2023, u arrit Marrëveshja shumë e rëndësishme për shtegun drejt normalizimit midis Kosovës e Serbisë. Kjo Marrëveshje e ndërmjetësuar nga BE-ja, që, ndër të tjera, parasheh njohjen “de facto” të Kosovës nga Serbia dhe anëtarësinë e Kosovës në organizatat ndërkombëtare,<sup>87</sup> është duke u përballur me sabotim nga Rusia. Disa ditë para arritjes së marrëveshjes, ambasadori rus në Beograd, Kharchenko, tha se zgjidhja e drejtë nuk mund të arrihet pa Rusinë dhe Kinën. Ai këtë e shihte si një përpjekje Perëndimore për t’ia dhënë Serbisë një mënyrë për ta njohur Kosovën, dhe që ajo t’i bashkëngjitet institucioneve ndërkombëtare, dhe posaçërisht KB. Harchenko e shprehte dyshimin që ky plan do të mund të shërbente si një themel i mirë për diskutimet e mëtutjeshme.<sup>88</sup> Pas marrëveshjes, zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme Ruse Zakharova e theksoi se kjo nuk e bën të mundur për Kosovën që ta fitojë anëtarësinë në organizatat ndërkombëtare, si Kombet e Bashkuara. Ajo i akuzoi ndërmjetësit e BE-së dhe të Shteteve të Bashkuara për përpjekjet afatgjata për t’ia rrënuar themelet kornizës ligjore ndërkombëtare për zgjidhjen për Kosovën, të theksuar para së gjithash në Rezolutën 1244 të KS KB. Sipas Zakharovas, ata synojnë të ushtrojnë tryzni në Serbinë për ta pranuar “shtetësinë famëkeqe të Kosovës.”<sup>89</sup>

Lidhur me këtë, Presidenti serb Vučić refuzoi ta nënshkruante Marrëveshjen për shtegun për normalizim<sup>90</sup> dhe pohoi se ai nuk do ta miratonte anëtarësinë e Kosovës në Kombet e

---

Tregtisë të Hungarisë Peter Szijjarto, Moskë, 21 korrik 2022. Në dispozicion në:

[https://mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1823197/](https://mid.ru/en/foreign_policy/news/1823197/);

Koment nga Zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme Maria Zakharova për deklaratat e Sekretarit të Përgjithshëm të KB për referendimet në rajonet Zaporozhnye dhe Kherson dhe në republikat popullore të Donetskut dhe Luganskut. Në dispozicion në: [https://mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1832119/](https://mid.ru/en/foreign_policy/news/1832119/).

Konferencë për shtyp e Ministrit të Jashtëm Sergey Lavrov për për çështjet europiane të sigurisë, Moskë, 1 dhjetor 2022. Në dispozicion në:

[https://mid.ru/en/press\\_service/photos/meropriyatiya\\_s\\_uchastiem\\_ministra/1841407/](https://mid.ru/en/press_service/photos/meropriyatiya_s_uchastiem_ministra/1841407/) ;

Vërejtjet e Ministrit të Jashtëm Sergey Lavrov dhe përgjigjet e tij në pyetjet në Primakov Readings International Forum, Moskë, 7 dhjetor 2022. Në dispozicion në: [https://mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1842506/](https://mid.ru/en/foreign_policy/news/1842506/);

Deklarata e Ministrit të Jashtëm Sergey Lavrov dhe përgjigjet e tij në pyetjet e medias gjatë konferencës së përbashkët për shtyp me Ministrin e Jashtëm të Republikës së Armenisë, Ararat Mirzoyan, Moskë, 20 mars 2023. Në dispozicion në: [https://mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1858773/](https://mid.ru/en/foreign_policy/news/1858773/).

<sup>87</sup> EEAS, Agreement on the path to normalization between Kosovo and Serbia, 27 shkurt 2023. Në dispozicion në: [https://www.eeas.europa.eu/eeas/belgrade-pristina-dialogue-agreement-path-normalisation-between-kosovo-and-serbia\\_en](https://www.eeas.europa.eu/eeas/belgrade-pristina-dialogue-agreement-path-normalisation-between-kosovo-and-serbia_en).

<sup>88</sup> Tanjug, Bocan-Harčenko: Rusija je podrška Beogradu - nema pravednog rešenja za KiM bez nas i Kine, 12 shkurt 2023. Në dispozicion në: <https://www.tanjug.rs/srbija/politika/13549/bocan-harcenko-rusija-je-podrska-beogradu-nema-pravednog-resenja-za-kim-bez-nas-i-kine/vest>.

<sup>89</sup> Shih për shembull, MPJ Ruse, Informim nga Zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme Maria Zakharova, Moskë, 9 mars 2023. Në dispozicion në: [https://mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1857501/3](https://mid.ru/en/foreign_policy/news/1857501/3); Informim nga Zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme Maria Zakharova, Moskë, 23 mars 2023. Në dispozicion në: [https://mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1859387/q16](https://mid.ru/en/foreign_policy/news/1859387/q16).

<sup>90</sup> Shih për shembull: N1, Vučić: Nisam potpisao, jer neću da pravim pravne sporazume sa Kosovom, 19 mars 2023. Në dispozicion në: <https://n1info.rs/vesti/vucic-nisam-potpisao-jer-necu-da-pravim-pravne-sporazume-sa-kosovom/>.

Bashkuara.<sup>91</sup> Goditja kryesore kësaj Marrëveshjeje iu dha me 15 dhjetor 2023, kur Serbia formalisht refuzoi që të pajtohej me të, ashtu siç u përcoll në letrën që iu drejtua BE-së nga Kryeministrja e Serbisë Brnabić.<sup>92</sup>

Një moment tejet i rrezikshëm për sigurinë rajonale ndodhi më 24 shtator 2023, kur një grup paramilitar serb që vepronte nga Serbia – njerëzit e vegjël të gjelbër – e bëri një aksion terrorist në Kosovën Veriore. Kjo rezultoi me vdekjen e një oficeri policor të Kosovës dhe të tre sulmuesve, praninë sporadike të të cilëve Presidenti Vučić tashmë e kishte shpallur që një vit më herët në një fjalim të tij në Parlamentin Serb.<sup>93</sup> Pas kësaj ngjarjeje, zyrtari i parë i jashtëm që e takoi Presidenti Vučić ishte Ambasadori rus në Serbi, Alexander Botsan-Kharchenko.<sup>94</sup> Pas takimit me Presidentin serb Aleksandar Vučić, Ambasadori rus Botsan-Kharchenko i kritikoi autoritetet e Prishtinës, duke i akuzuar ato për dhunën e vazhdueshme, dhe duke e fajësuar posaçërisht Kryeministrin e Kosovës Kurti, për ndjekjen e një kursi që i kërcënonte zonat e banuara me serbë. Ai pohonte se Perëndimi i inkurajonte veprimet e tilla dhe e kritikonte dialogun në Bruksel, duke e emërtuar atë si mbulesë për ngjarjet e vërteta në Kosovë, të cilave u mungojnë çfarëdo rezultatesh domethënëse. Ambasadori rus po ashtu e shprehu pakënaqësinë me misionin e NATO-s të udhëhequr nga KFOR-i, duke pretenduar se ai jo vetëm që ka dështuar në detyrat e tij, por po ashtu i ka ndihmuar forcat policore në dhunën kundër “civilëve” gjatë përplasjeve të kohëve të fundit në Kosovë.<sup>95</sup>

### III. Interesat e Rosisë në dialogun Kosovë–Serbi

Nga diskursi zyrtar dhe veprimet diplomatike të Moskës, nuk është e lehtë të dihet se çfarë Federata Ruse me të vërtetë dëshiron nga dialogu midis Kosovës e Serbisë. Mirëpo, ashtu siç është treguar në seksionin paraprak, Moska është e qartë për atë se çfarë ajo nuk dëshiron nga procesi i dialogut në Bruksel. Domethënë, Federata Ruse nuk dëshiron që procesi i dialogut të

---

<sup>91</sup> Shih për shembull: Politika, Vučić: Nikada neću pristati na priznanje i ulazak Kosova u UN, o svemu ostalom možemo da pregovaramo, 28 shkurt 2023.

<sup>92</sup> Jelena Nikolić, Serbia formally refuses to abide by EU-brokered agreements with Kosovo, Euraktiv, 15 dhjetor 2024, Në dispozicion në: <https://www.euractiv.com/section/politics/news/serbia-formally-refuses-to-abide-by-eu-brokered-agreements-with-kosovo/>.

<sup>93</sup> KoSSev, Vučić: Po prvi put se pojavila lica u uniformama na Severu, sve žene sišle da ih pozdrave i kažu ‘dobrodošla sloboda’, 13 shtator 2023, <https://kossev.info/na-barikadama-se-pojavila-lica-u-uniformama-sve-zene-sisle-da-ih-pozdrave-i-kazu-dobrodošla-sloboda/>

<sup>94</sup> Danas, Zašto se predsednik Srbije, nakon sukoba u Banjskoj, prvo sreo sa ruskim ambasadorom: Hteo da pokaže da i Srbija ima saveznike, 26 shtator 2023, <https://www.danas.rs/vesti/politika/ruski-ambasador-vucic-banjska-sukob/>

<sup>95</sup> Danas, Kako ruski ambasador vidi tragediju u Banjskoj i scenario dešavanja u UN?,



përfundojë me sukses sipas projekteve të Perëndimit. Kjo do ta nënkuptonte mbylljen e problemit më të mprehtë të mbetur nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë, pa përfshirjen e drejtpërdrejtë të Ruisë si pjesë e “përpyekjeve ndërkombëtare.” Nga një skenar i tillë Federatës Ruse do t’i dilnin tri implikime. Së pari, kjo do të ishte një demonstrim i qartë i ndikimit të zvogëluar të Ruisë në çështjet botërore. Së dyti, kjo do të çonte në konsolidimin e shtetësisë së Kosovës dhe të sigurisë rajonale. Së treti, mbyllja e problemeve me Kosovën do të ishte një nxitje e madhe për orientimin e Serbisë drejt Perëndimit, dhe, rrjedhimisht, braktisje e orbitës ruse në të cilën Serbia për momentin është duke lëvizur.

Qëllimet e veçanta politike të Federatës Ruse përballë dialogut Kosovë–Serbi janë të ndërthurura dhe të katërfishta. *Së pari*, t’ia rrënojnë themelet shtetësisë së Kosovës, e cila do të thotë t’i zhbëjnë efektet e Planit të Ahtisaarit dhe të Opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për legalitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. *Së dyti*, t’i diskreditojnë politikat perëndimore ndaj dialogut Kosovë–Serbi dhe ta rrisin sa më shumë që të jetë e mundur rolin e KB. Kjo e nënkupton ri-fitimin e drejtpërdrejtë të një roli aktiv të Moskës në këtë proces. *Së treti*, ta forcojnë rolin e Ruisë në Ballkan, dhe posaçërisht përmes mbajtjes së ndikimit rus në Serbi, dhe në mesin e aktorëve anti-perëndimorë në rajon. *Së katërti*, të grumbullojë përfitime në Ukrainë dhe në Gjeorgji, përmes politikave transaksioniste në të cilat Kosova do të përdoret si një monedhë shkëmbimi (ky aspekt do të trajtohet ndaras).

Në këtë dritë, narrativi zyrtar i Moskës është që statusi i Kosovës mbetet një konflikt i pazgjidhur, i cili mund të zgjidhet vetëm përmes negociatave midis Prishtinës dhe Beogradit bazuar në një zgjidhje e cila është e pranueshme për Serbinë.<sup>96</sup> Domethënë, pavarësisht nga Opinioni Këshillues i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, i cili konfirmoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ishte në kundërshtim me Rezolutën 1244 të KS KB, Moska e paraqet një interpretim të kundërt, duke pretenduar se në sajë të kësaj Rezolutive Kosova vazhdon të jetë territor nën administrimin e KB dhe me një status përfundimtar të pazgjidhur.<sup>97</sup> Ky qëndrim është artikuluar qartë nga Ministri i Jashtëm Lavrov, ashtu siç është theksuar në pjesën paraprake. Kështu, disa javë pas fillimit të procesit të dialogut midis Kosovës dhe Serbisë në

---

<sup>96</sup> MPJ Ruse. Transkripti i Vërejtjeve dhe Përgjigjeve në Pyetjet e Medias nga Ministri i Punëve të Jashtme Sergey Lavrov në Konferencën e Përbashkët për Shtyp me Ministrin Serb të Punëve të Jashtme, Vuk Jeremić, Moskë, 17 korrik 2008. Në dispozicion në:

[https://www.mid.ru/en/press\\_service/minister\\_speeches/1590415](https://www.mid.ru/en/press_service/minister_speeches/1590415).

<sup>97</sup> MPJ Ruse, Koment nga Ministri i Punëve të Jashtme të Federatës Ruse në Raport me Miratimin nga Asambleja e Përgjithshme e KB të Rezolutës për Opinioni Këshillues për Kosovën të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, Moskë, 10 shtator 2010. Në dispozicion në:

[https://www.mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1597928/?lang=en](https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1597928/?lang=en).

Bruksel, Lavrovi pohoi se, “Rusia e përkrah qëndrimin e Serbisë i cili bazohet në realitetet legale ndërkombëtare të konfirmuara në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë të KB. Është ky pike vështrimi i favorshëm nga i cili ne i qasemi dialogut që është filluar midis Beogradit e Prishtinës në pajtim me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të KB të miratuar në shtatorin 2010. Ne jemi po ashtu në favor të asaj që askush të mos përpiqet ta nënçmojë rolin i cili sipas kësaj rezolute i është caktuar Misionit të KB në Kosovë.”<sup>98</sup>

Në kuadër të kësaj strategjie, përkrahja e Ruisë për Serbinë lidhur me rastin e Kosovës ka qenë e qëndrueshme dhe e pakushtëzuar. Serbia jo vetëm që është aleat tradicional i Ruisë, por është edhe shpresa më e rëndësishme – nëse jo edhe e vetmja – që Moskë t’i ketë hundët e veta të futura në Ballkan. Ashtu siç Ministri i Jashtëm Lavrov e siguronte homologun e vet serb gjatë vizitës së tij në Moskë në qershorin 2008, “Rusia do ta përkrahë çdo vendim, çdo zgjidhje e cila do të jetë e pranueshme për Beogradin. Ky qëndrim joni është thelbësor dhe mbetet në fuqi.”<sup>99</sup>

Nga ana tjetër, një qëllim tjetër i Ruisë është që ta diskreditojë rolin e BE-së dhe të SHBA-ve në procesin e dialogut Kosovë–Serbi dhe që ta (ri-)kthejë një rol më të spikatur të Këshillit të Sigurisë të KB – ku e ka forcën e vetos. Ashtu siç u theksua më sipër, Moskë e humbi çdo mundësi formale të ndikimit mbi këtë proces në vitin 2010, kur menjëherë pas Opinionit të GJND-së, dialogu midis Kosovës dhe Serbisë u bart nën ombrellën e BE-së. Që nga fillimi i luftës në Kosovë, në vitin 1998 dhe deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, Rusia ka qenë pjesë e përpjekjeve ndërkombëtare ndaj krizës së Kosovës. Duke e marrë haptas një qëndrim të njëanshëm, Rusia, gjatë gjithë konfliktit Kosovë–Serbi, në të gjithë momentet vendimtare e ka larguar veten nga veprimet ndërkombëtare kolektive. Megjithatë, ashtu siç Dimitar Bechev e ka theksuar me të drejtë, dhe siç është nënvizuar në pjesën paraprake, Rusia është detyruar më shumë se një herë të bëjë kompromise dhe të bashkohet me Perëndimin – për shembull, duke i autorizuar *ex post* intervenimet perëndimore në Këshillin e Sigurisë të KB dhe duke iu bashkangjitur misioneve paqeruajtëse të NATO-s të tilla si IFOR/SFRO-ja në Bosnje, dhe KFOR-i në Kosovë.<sup>100</sup>

---

<sup>98</sup> MPJ Ruse, Vërejtje dhe Përgjigje nga Ministri i Jashtëm Rus Sergey Lavrov në Pyetjet e Medias në Konferencën e Përbashkët për Shtyp Pas Bisedimeve me Ministrin e Jashtëm Serb, Vuk Jeremić, Beograd, 19 prill 2011. Në dispozicion në: [https://www.mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1701838](https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1701838).

<sup>99</sup> *Ibid.*

<sup>100</sup> MPJ Ruse, Koment nga Ministria e Punëve të Jashtme të Federatës Ruse Lidhur me Miratimin nga Asambleja e Përgjithshme e KB të Rezolutës për Opinionin Këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Kosovën, Moskë, 10 shtator 2010. Në dispozicion në:

Mbetet të shihet nëse kjo histori do të përsëritet në kontekstin e procesit të dialogut aktual midis Kosovës dhe Serbisë. Rusia e ka ndjekur një qëndrim ambivalent ndaj këtij procesi. Ashtu siç e nënvizon Lance Davies, Moska ka argumentuar vazhdimisht se vetëm Këshilli i Sigurisë e ka “autoritetin procedural për ta trajtësuar një rezultat të negociuar që i mbështet parimet kyçe të së drejtës ndërkombëtare dhe që e mbron zërin e Moskës në marrjen e vendimeve.”<sup>101</sup> Vladimir Putini e ka shprehur herë pas here qëndrimin e Moskës, duke nënvizuar se Rusia e përkrah “një zgjidhje të zbatueshme dhe reciprokisht të pranueshme nga dialogu Kosovë–Serbi që duhet të bazohet në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë të KB.”<sup>102</sup> Krahas këtyre vijave, në një intervistë me një medium serb, në vitin 2018, Ministri i Jashtëm Lavrov vajtonte se “Askush nuk e ka anuluar Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë së KB. Kjo duhet të jetë pikënisja.”<sup>103</sup> Ky ka qenë qëndrimi i paramenduar i Federatës Ruse i shprehur në mënyrë konsistente dhe posaçërisht gjatë takimeve periodike të Këshillit të Sigurisë për Kosovën. Rusia në mënyrë të paramenduar i shmanget përmendjes së Opinionit të GJND-së, i cili e shprehimisht e konfirmoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ka qenë në kundërshtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë të KB.

Paralelisht me theksimin e rolit të synuar të KB si një arbitër përfundimtar në procesin e dialogut midis Kosovës e Serbisë, Rusia e ka fajësuar Perëndimin për zbrapsje në dialog. Mesazhet e përkrahjes për përparime në këtë proces ishin të rralla dhe pasive. Përpjekjet për ta paraqitur BE-në si të paaftë për ta drejtuar procesin e dialogut, dhe Perëndimin si të njëanshëm, u shprehën nga Moska në raste të shumta, dhe posaçërisht si reagim ndaj zhvillimeve të rëndësishme në dialog ose lidhur me Kosovën. Së fundi, kur opozita serbe i ka filluar protestat paqësore në rrugë kundër mashtrimeve të pretenduara masive elektorale nga Aleksandar Vučići, në dhjetor 2023, Federata Ruse e akuzoi Perëndimin për vënien në skenë të grusht-shtetit kundër qeverisë në Beograd. Ministri Lavrov dhe Ambasadori Rus në Serbi e

---

[https://www.mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1597928/?lang=en](https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1597928/?lang=en).

<sup>101</sup> Davies, Lance. 2021. “A hybrid offensive in the Balkans? Russia and the EU-led Kosovo-Serb negotiations,” *European Security*, Vol.31(1), 2022, fq. 4.

<sup>102</sup> Kremlin, Deklarimet për shtyp pas bisedimeve Ruso-Serbe, dhjetor 2017. Në dispozicion në: <http://en.kremlin.ru/events/president/transcripts/56418>.

<sup>103</sup> MPJ Ruse, Intervista e Ministrit Rus të Punëve të Jashtme, Sergey Lavrov, për agjencinë serbe të lajmeve Beta, shkurt 2018. Në dispozicion në: [https://veleposlanistvorusije.mid.ru/en/press-centre/news/foreign\\_minister\\_sergey\\_lavrov\\_s\\_interview\\_with\\_serbian\\_information\\_agency\\_beta](https://veleposlanistvorusije.mid.ru/en/press-centre/news/foreign_minister_sergey_lavrov_s_interview_with_serbian_information_agency_beta).

cilësuan këtë ngjarje si ndëshkim të Serbisë nga ana e Perëndimit, “për refuzimin e njohjes së Kosovës dhe të futjes së sanksioneve ndaj Rusisë.”<sup>104</sup>

Avancimi i qëndrimit të saj në Ballkan është një dimension tjetër i qasjes së Rusisë ndaj marrëdhënieve konfliktuale midis Kosovës dhe Serbisë. Moska Ballkanin e percepton si një element të rëndësishëm në pamjen e madhe të marrëdhënieve të veta me Perëndimin, dhe posaçërisht me SHBA-të. Prandaj, në një këndvështrim historik, ajo se a ka vepruar Moska si një pengues apo partner i përpjekjeve Perëndimore në Ballkan ka ndryshuar. Kjo është varur në masë të madhe nga marrëdhëniet e përgjithshme të Rusisë me vendet Perëndimore në një çast të caktuar në kohë, dhe, nga ky këndvështrim, nga ajo se a janë përputhur apo kundërshtuar interesat e tyre në Ballkan.

Rusia është e vetëdijshme që ajo nuk mund ta merr një rol të rëndësishëm në Ballkanin Perëndimor, në një mënyrë që të mund ta trajtësojë rrjedhën e ngjarjeve. Ajo këtë mund ta bëjë vetëm në partneritet me SHBA-të dhe me vendet evropiane. Në mungesë të një agjende të tillë të përbashkët, e vetmja alternativë për Moskën është që t’i prishë agjendat Perëndimore në Ballkanin Perëndimor.

Në kuadër të këtij mjedisi të përgjithshëm, qëllimi i madh gjeopolitik i Federatës Ruse është që ta vonojë dhe pengojë zgjerimin e strukturave Euro-Atlantike në Ballkanin Perëndimor. Moska kurrë nuk e ka pranuar lehtë idenë e Ballkanit të rrënjosur fuqishëm në strukturat euro-atlantike. Rrjedhimisht, qëllimi kryesor i Rusisë ka qenë që ta pengojë sa më shumë që të jetë e mundshme integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në strukturat euro-atlantike, dhe posaçërisht në NATO.

Ashtu siç Maksim Samorukov i Carnegie Moscow Center e vëren në mënyrë të përmbledhur, edhe pse Rusia haptas e kundërshton vetëm zgjerimin e NATO-s në Ballkan, kjo praktikisht e kundërshton po ashtu edhe zgjerimin e BE-së në këtë rajon. Zgjerimi i NATO-s shihet si një kërcënim i drejtpërdrejtë para së gjithash për shkak të frikës se, një herë pasi që i tërë Ballkani të përfshihet në strukturat e NATO-s, rruga do të jetë e shtruar për Aleancën që ajo të zgjerohet drejt hapësirës ish-sovjetike, që do të thotë Ukrainës, Moldavisë dhe Gjeorgjisë. Nga ana tjetër, Rusia zyrtarisht nuk e kundërshton përfshirjen e Ballkanit në BE, por në fakt interesin e ka që këtë proces ta vonojë dhe ta pengojë sa më shumë që të jetë e mundur, dhe posaçërisht sa i

---

<sup>104</sup> Intervistë e Ministrit të Jashtëm Sergey Lavrov me Sputnikun dhe Russia 2, e cituar në N1info.rs, dhjetor 2023. Në dispozicion në: [Lavrov: West tried to make Serbia choose between sanctions on Russia, coup d'état \(n1info.rs\)](https://n1info.rs).

përket Serbisë. Moska është e vetëdijshme se një herë pasi që Serbia të integrohet në BE, Beogradi duhet ta rreshtojë politikën e vet të jashtme me BE-në – e që, ndër të tjera, do të thotë vendosjen e sanksioneve ndaj Ruisë, vendosjen e regjimit të vizave për qytetarët rusë, dhe ndaljen e bashkëpunimit intensiv ushtarak dhe të sigurisë me Rusinë.<sup>105</sup>

Serbia dhe forcat politike nacionaliste serbe në rajon janë shtysa më e vlefshme që Rusia e ka për ta marrë ndikimin në Ballkanin Perëndimor dhe për t'i ndjekur qëllimet e veta të prishjes së mbërthimit të fuqishëm të rajonit nga ana e NATO-s. Duhet përmendur që narracioni tradicional i cili i shpjegon lidhjet strategjike midis Serbisë dhe Ruisë përmes farefisnisë etnofetare, apo faktorëve historikë, është me të meta. Në të vërtetë, as nga regjistrimet historike, dhe as nga aspekti fetar, Rusia nuk është më e afërt me Serbinë se me vendet e tjera sllave ortodokse të Ballkanit, të tilla si Bullgaria, Mali i Zi, apo Maqedonia. Të gjitha këto vende janë pjesë të NATO-s, dhe megjithatë kanë marrëdhënie normale me Rusinë. Ato asnjëherë nuk e kanë vënë veten në çfarëdo udhëkryqi midis Ruisë dhe Perëndimit në një asi mënyre në të cilën këtë e bën Serbia. Prandaj, lidhja midis Serbisë dhe Ruisë është para së gjithash refleksion i faktit se Serbia e ka gëzuar një përkrahje të palëkundur dhe të pakushtëzuar nga Moska gjatë të gjitha luftërave të përgjakshme në ish-Jugosllavi. Kjo përkrahje prej Ruisë ka qenë e pakushtëzuar por jo edhe falas. Domethënë, Moska Serbinë e ka perceptuar si një “pengesë rrugore” për përhapjen Perëndimore në Ballkan. Alexander Dugin, filozofi politik rus me ndikim i të djathtës ekstreme, i cili shpesh herë emërtohet edhe si “truri i Putinit,” e lavdëronte Serbinë për “zgjimin e botës multipolare” duke luftuar kundër NATO-s. Ai e dha këtë deklaratë gjatë vizitës së ekspozitës që i është kushtuar kësaj lufte, të quajtur “Defence 78” [“Mbrotjtja 78”] në shoqëri me ish Shefin e Inteligjencës së Serbisë, Aleksandar Vulin.<sup>106</sup> Në realitet, Serbia, nuk ka, as kapacitet, dhe as ambicie, për ta vënë në lëvizje çfarëdo qoftë lloji të botës multipolare. Mirëpo, Serbia ka dëshmuar se e ka vullnetin dhe aftësinë për të shërbyer si një instrument i Ruisë për qëllimin e çrregullimit të zgjerimit euro-atlantik në Ballkan. Serbia e bën këtë qoftë duke nxitur jo stabilitet në Bosnje e Hercegovinë, Mal të Zi, ose Kosovë, ose përmes mbajtjes së bashkëpunimit të ngushtë ushtarak, politik dhe ekonomik me Moskën. Në pamje, Serbia është duke e ndjekur një politikë të jashtme “multi-vektoriale.” Mirëpo, në realitet Beogradi anon qartë drejt Moskës, ndësa BE-ja i ka hapur 21 nga 35 kapitujt

---

<sup>105</sup> Center for Strategic and International Studies, Debat për Garën SHBA–Rusi në Ballkanin Perëndimor, Washington, mars 2020, Në dispozicion në: [U.S.-Russia Competition in the Western Balkans \(youtube.com\)](https://www.youtube.com/watch?v=U.S.-Russia%20Competition%20in%20the%20Western%20Balkans).

<sup>106</sup> Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Serbisë, Postim i Ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Serbisë, Beograd, nëntor 2019. Në dispozicion në: <https://www.mod.gov.rs/eng/tekst/14739/profesor-dugin-srbi-su-1999-probudili-mnogopolarni-svet-14739>.

gjatë bisedimeve të aksesionit me Serbinë që filluan në vitin 2013.<sup>107</sup> Rrjedhimisht, ashtu siç tashmë është theksuar, BE-ja e ka humbur një shtysë të pazëvendësueshme ndaj drejtimit të politikës së jashtme të Serbisë.

### ***Përpyekjet e Rusisë për të tërhequr paralele midis Kosovës dhe Ukrainës e Gjeorgjisë***

Sulmi ushtarak kundër Ukrainës e ka dhënë dy efekte për politikën e Rusisë ndaj Kosovës. *Së pari*, Rusia e ka humbur çdo interes për të bashkëpunuar me Perëndimin për dialogun midis Kosovës dhe Serbisë dhe është bërë më përçarëse në rajon. Ky aspekt është analizuar më sipër. Aspekti *i dytë* është rigjallërimi nga Moska i “precedentit të Kosovës,” për të përligjur, përsëri, luftën e vet agresive kundër Ukrainës. Putini iu referua rastit të Kosovës, së pari në aneksimin ilegal të Krimesë në vitin 2014, dhe më pastaj për ta justifikuar agresionin ushtarak në shkallë të plotë kundër Ukrainës dhe në pranimin e pavarësisë së rajoneve të Donetskut dhe të Luhanskut në shkurt 2022 (kështu ka bërë po ashtu edhe për justifikimin e luftërave aneksuese kundër Gjeorgjisë në vitin 2008). Në justifikimin e vendimit për ta shpallur pavarësinë e Krimesë, në mars 2014, të cilën më vonë e “integroi” me Rusinë, Parlamenti i Krimesë<sup>108</sup> dhe të zotët e tij në Moskë<sup>109</sup> iu referuan Opinioni Këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Kosovën.

Në vitin 2022, Putini u përpoq përsëri që ta krijonte një tjetër “precedent kosovar” me qëllim që ta justifikonte “operacionin special ushtarak” të tij – një emërtim ky që Rusia ia dha agresionit të plotë ushtarak kundër Ukrainës. “Republikat e Donbasit e kanë të njëjtën të drejtë që ta shpallin sovranitetin e tyre, si edhe Kosova, që nga koha kur precedenti u vendos. Apo jo? A pajtoheni me këtë?” Putini ia shtronte me cinizëm këtë pyetje Sekretarit shfajësues të Përgjithshëm të KB, Antonio Gutierrezit, gjatë një takimi në Moskë, më 25 prill 2022.<sup>110</sup>

---

<sup>107</sup> EU in Serbia, Chapters Opened and Closed, Në dispozicion në: <https://europa.rs/chapters-opened-and-closed/?lang=en>.

<sup>108</sup> Russia Today, Crimea Parliament declares Independence from Ukraine ahead of Referendum, 11 mars 2014. Në dispozicion në: <https://www.rt.com/news/crimea-parliament-independence-ukraine-086/>.

<sup>109</sup> Kremlin, Address by the President of the Russian Federation, March 18, 2014, Në dispozicion në: [eng.kremlin.ru/news/6889](http://eng.kremlin.ru/news/6889).

<sup>110</sup> Agjencia Ruse e Lajmeve TASS, Putin cites precedent of Kosovo in explaining recognition of DPR, LPR, prill 2022, Në dispozicion në: [https://tass.com/politics/1443661?utm\\_source=bing.com&utm\\_medium=organic&utm\\_campaign=bing.com&utm\\_referrer=bing.com](https://tass.com/politics/1443661?utm_source=bing.com&utm_medium=organic&utm_campaign=bing.com&utm_referrer=bing.com).

Qëndrimi dhe argumentet e Ruisë për këtë çështje kanë qenë konfuzë dhe kundërthënëse. Ky aspekt është nënvizuar në pjesën pararendëse të kësaj analize. Herë pas here, Rusia përpqej të tërhiqte paralele midis Kosovës me Krimesë, Ukrainës Lindore dhe me territoret e pushtuara nga rusët në Gjeorgji. Herëve të tjera, Moska pretendonte se këto situata janë të ndryshme. Moska përpqej të identifikonte dallime midis Kosovës dhe Krimesë duke argumentuar se “në Krime, nuk ka pasur rezoluta paraprake që janë kaluar nga Këshilli i Sigurisë për t’i dhënë themel ndonjë zgjidhjeje të veçantë legale. Prandaj, një referendum i bazuar në shprehjen e lirë të banorëve të Krimesë është alternativa evidente legale.”<sup>111</sup>

Dhe, vërtetë, përpjekjet për të tërhequr paralele midis Kosovës dhe rajoneve separatiste të Ukrainës të cilat janë pushtuar nga Rusia, janë mashtruese dhe manipuluese. Kosova ka qenë pjesë përbërëse e Federatës Jugosllave – një vend që është shpërbërë. Në vitin 1999, NATO ka intervenuar për ta ndalur gjenocidin në rrjedhje e sipër të Beogradit kundër popullit të Kosovës dhe ky intervenim ishte paraprak nga disa rezoluta të KS KB që ishin miratuar nën Kapitullin VII të Kartës së KB. Rezoluta 1244 e kishte vënë Kosovën nën administrimin ndërkombëtar, dhe Kosova e shpalli pavarësinë e vet pas tetë vitesh të administrimit të KB dhe rreth tre vjet pas procesit të drejtuar ndërkombëtar për përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës. Shpallja e pavarësisë së Kosovës u bazua në propozimin e parashtruar nga i Dërguari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB, Martti Ahtisaari. Më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e lëshoi një Opinion Këshillues që e konfirmonte që përvetësimi i deklaratës së pavarësisë së Kosovës ka qenë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

Asnjë nga këto kondita nuk janë të pranishme për territoret e Ukrainës (dhe të Gjeorgjisë) të pushtuara nga Federata Ruse. Pavarësia e vetë-proklamuar dhe aneksimi i më pastajmë i Krimesë, si dhe shpalljet e vetë-proklamuar të pavarësisë së Donetskut dhe të Luhanskut ishin rezultate të drejtpërdrejta të agresioneve që Federata Ruse i bëri kundër Ukrainës, më 2014 dhe 2022. Kjo jo ligjshmëri e veprimeve të Ruisë kundër Ukrainës dhe separatizmi në Krime, Donetsk dhe Luhansk, janë të konfirmuara nga disa rezoluta të Asamblesë së Përgjithshme të KB.

---

<sup>111</sup> MPJ Ruse, Intervistë për media, 15 maj 2015. Në dispozicion në: [http://www.mid.ru/en/web/guest/maps/rs/-/asset\\_publisher/GLz7aPgDnSfP/content/id/1279577](http://www.mid.ru/en/web/guest/maps/rs/-/asset_publisher/GLz7aPgDnSfP/content/id/1279577).

Mirëpo, synimet e vërteta të Moskës nuk janë të ndërtuara në trajtën e argumenteve, por që të jenë monedha për shkëmbim. Shkëmbimet janë manifestime tipike të strategjisë transaksioniste që Moska e ndjek në mënyrë energjike ndaj Kosovës.

#### **IV. Dimensioni i sigurisë, bashkëpunimi ushtarak dhe interesi ekonomik i Ruisë në rajon**

Aspekti i sigurisë i përfshirjes së Ruisë: Çështjet e hapura etnike në Ballkanin Perëndimor e paraqesin para së gjithash një problem të sigurisë për komunitetin euro-atlantik. Marrëdhëniet konfliktuoze midis Kosovës e Serbisë, politikat secesioniste të entitetit serb në Bosnje, dhe polarizimi i thellë midis grupit pro-perëndimor dhe atij anti-perëndimor në Mal të Zi, janë problemet më të mprehta të sigurisë në oborin e pasmë Euro-Atlantik. Prandaj, Ballkani Perëndimor e paraqet të vetmin terren ku Moska mund ta ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në dinamikën e (pa)sigurisë të Perëndimit.

Në këtë mjedis, Federata Ruse i ka dy interesa të drejtpërdrejta: i pari, ta parandalojë stabilizimin e rajonit në kuadër të parametrave euro-atlantikë. I dyti, ta forcojë ndikimin e tërësishëm të Moskës mbi shtetet përkrahëse në rajon, dhe posaçërisht mbi Serbinë.

Sa i përket qëllimit të parë, stabiliteti i Ballkanit Perëndimor e sjell këtë rajon më afër strukturave Perëndimore, dhe kjo shkon kundër interesave të Moskës. Moska e ka shfrytëzuar çdo krizë të madhe politike në rajon – së bashku me atë të Kosovës – për ta akuzuar Perëndimin dhe për ta forcuar ndikimin rus në rajon – posaçërisht ndër serbët. Kështu, në vitin 2015 shpërthyen protesta masive në Maqedoni, pas lëshimit të audio-regjistrimeve që i zbulonin skandalet korruptive të qeverisë së mëparshme të Nikola Gruevskit – që ishte një udhëheqës autoritar me prirje pro-Moskës. Federata Ruse e akuzoi Perëndimin për vënien në skenë të edhe një “revolucionit të ngjyrosur kundër autoriteteve legjitime” dhe për “komplotimin për ta destabilizuar Ballkanin.”<sup>112</sup> Madje edhe më i rrezikshëm ishte skenari që u luajt në Mal të Zi gjatë viteve 2015–2016. Fillimisht, Rusia i përkrahu protestat anti-qeveritare të tetorit 2015, ndërkohë që mijëra veta u tubuan në kryeqytetin e Podgoricës kundër anëtarësisë në NATO. Një vit më vonë, në tetorin 2016, në prag të zgjedhjeve parlamentare, autoritetet njoftuan se

---

<sup>112</sup> Bieber dhe Nikolaos Tzifakis (red.), “The Western Balkans in the World: Linkages and Relations with Non-Western Countries,” *South East European Studies*, Vol. 20, 2009, fq. 197.



ato e kanë zmbarsur një komplot për ta përmbysur qeverinë, për ta vrarë Kryeministrin Milo Djukanović dhe për ta nxjerrë Malin e Zi nga binarët e hyrjes në Aleancën Atlantike. Sipas Prokurorisë, konspiracioni i pretenduar është udhëhequr nga oficerët e sigurisë nga Serbia, të udhëzuar nga GRU-ja, inteligjenca ushtarake ruse, dhe në kontakt me opozitën anti-NATO të Malit të Zi.<sup>113</sup> Që nga prilli 2022, kur sundimit tre-dekadash të udhëheqësit pro-perëndimor Milo Djukanović i erdhi fundi, Mali i Zi hyri në një periudhë të jo stabilitetit të thellë politik. Më e rëndësishmja, blloku politik anti-Perëndimor ka qenë i trimëruar, ndërsa Kisha Ortodokse Serbe në Mal të Zi i ka vazhduar aktivitetet e veta politike të cilat në mënyrë të qenësishme janë kundër pavarësisë së Malit të Zi. Qeveria e fundit e Malit të Zi, e krijuar më 31 tetor 2023, e ka pasur mbështetjen e partive politike pro-ruse, dhe, si shpërblim për këtë, politikani i vendosur anti-NATO Andrija Mandić është zgjedhur si kryetar i Parlamentit. Edhe përkundrejt garancive të Kryeministrit të ri Milojkko Spajić që përkushtimet pro-BE dhe pro-NATO të Malit të Zi mbeten të palëkundura, ka arsye të mira për t'u frikësuar për trajektoren e paparashikueshme të këtij vendi. Rusia është përpjekur me këmbëngulje të ushtrisë ndikim malinj në Mal të Zi, përmes propagandës, përkrahjes për forcat politike pro-serbe dhe për Kishën Ortodokse Serbe në Mal të Zi – ku kjo e fundit ka qenë instrumentale në mobilizimin e përkrahjes prapa ideologjisë së pan-sllavizmit ortodoks nën udhëheqjen ruse.<sup>114</sup>

Veprimet subversive të Rusisë janë më energjike në Bosnje e Hercegovinë, ku Moska e ka ofruar një përkrahje të palëkundur për politikën secesioniste të udhëheqësit nationalist serb Milorad Dodik, duke synuar që të shkatërrohet funksionaliteti i shtetit boshnjak.<sup>115</sup> Kohëve të fundit, më 9 janar 2024, *Republika Serbe* e ka organizuar një paradë të tipit ushtarak për ta kremtuar ditën e këtij entiteti – pavarësisht nga vendimi paraprak i Gjykatës Kushtetuese që e kishte ndaluar kremtimin e kësaj dite si jokushtetues. Ajo që është edhe më tepër, udhëheqësi i serbëve të Bosnjes, Milorad Dodik, e ka vazhduar retorikën e tij provokative duke u zotuar përsëri se do të punojë për shpërbërjen e Bosnjes e Hercegovinës.<sup>116</sup> Duhet të rikujtohet se Bosnja e Hercegovina është një vend kandidat për anëtarësinë në BE që nga dhjetori 2022, dhe se në dhjetorin 2023 Këshilli Europian madje ka vendosur që t'i fillojë negociatat për aksesion

---

<sup>113</sup> *Ibid.*, p. 198.

<sup>114</sup> Center for Strategic & International Studies, Russian Malign Influence in Montenegro: The Weaponization and Exploitation of History, Religion, and Economics, 14 maj 2019. Në dispozicion në: <https://www.csis.org/analysis/russian-malign-influence-montenegro-weaponization-and-exploitation-history-religion-and-economics> .

<sup>115</sup> *Ibid.*

<sup>116</sup> Balkan Insight, Defiant Bosnian Serbs Celebrate Banned Holiday, Honour Hungary's Orban, 9 janar 2024. Në dispozicion në: <https://balkaninsight.com/2024/01/09/defiant-bosnian-serbs-celebrate-banned-holiday-honour-hungarys-orban/>.

me Bosnjën e Hercegovinën. Për më tepër, Bosnja dhe Hercegovina është anëtare e programit Partneriteti për Paqe me NATO-n që nga viti 2006, dhe në vitin 2010 ajo është ftuar për t'iu bashkangjitur Planit të Aksionit për Anëtarësim.

Bashkëpunimi ushtarak dhe i sigurisë midis Rusisë e Serbisë: Një instrument tjetër i ndikimit të Rusisë në stabilitetin rajonal është i ndërlidhur me bashkëpunimin e saj të ngushtë ushtarak dhe të sigurisë me Serbinë. Pas shpërthimit të protestave të opozitës në Serbi lidhur me pretendime serioze për mashtrime zgjedhore, në dhjetor 2023, Kryeministrja Brnabić ia dha lëvdatat shërbimeve sekrete ruse për informimin e autoriteteve serbe “për përgatitjen e trazirave nga shërbimet inteligjente të huaja (domethënë, Perëndimore).” Kjo u përsërit nga Presidenti Vučić i cili shprehu falënderimin ndaj inteligjencës së huaj – duke aluduar në shërbimin sekret rus – dhe e akuzoi “një vend Perëndimor për përgatitjen e skenarit të Maidanit në Serbi.” Në ditët e ardhshme, mediat pro-regjimit në Serbi e akuzonin haptas Gjermaninë për komplot për ta vënë në skenë një skenar të tipit të Maidanit kundër regjimit të Vučićit– një akuzë kjo që fuqimisht është mohuar nga Berlioni.<sup>117</sup> Ky episod e konfirmoi, përsëri, bashkëpunimin e ngushtë të shërbimeve inteligjente midis Federatës Ruse dhe Serbisë – madje edhe pas dorëheqjes së ish-kreut të vendosur pro-rus të shërbimit të inteligjencës së Serbisë, Aleksandar Vulin.

Nga ana tjetër, Serbia dhe Rusia kanë përjetuar rritje të vazhdueshme të bashkëpunimit të tyre ushtarak, e cila ka ndodhur në tri forma. Së pari, që nga 2011, Rusia vepron në një “bazë humanitare” në qytetin e Nishit në Serbi (rreth 100 kilometra afër kufirit me Kosovën). Nuk nevojitet ndonjë analizë e thellë për të kuptuar që gjëja e fundit në të cilën Kremli do të donte të futej është që të kryente operacione humanitare në Ballkan! Besohet gjerësisht se kjo bazë shfrytëzohet për aktivitete spiunazhi, para së gjithash kundër operacioneve të NATO-s në rajon.<sup>118</sup>

Forma e dytë e bashkëpunimit të afërt ushtarak midis Federatës Ruse dhe Serbisë është përmes kontratave dhe donacioneve të prokurimit të armatimit. Kjo formë e bashkëpunimit është rritur në mënyrë progresive që nga 2017 dhe kjo përfshinte, ndër të tjera, donacionet Serbisë të katër helikopterëve MI-35 dhe tridhjetë helikopterëve të blinduar të zbulimit, të mjeteve

---

<sup>117</sup> European Western Balkans, The narrative of the “new Maidan,” an old tool of Serbian authorities to discredit anti-regime protests, 28 dhjetor 2023. Në dispozicion në: <https://europeanwesternbalkans.com/2023/12/28/the-narrative-of-the-new-maidan-an-old-tool-of-serbian-authorities-to-discredit-anti-regime-protests/>.

<sup>118</sup> Euroactive, Russia opens “humanitarian” base in Serbia, 18 tetor 2011. Në dispozicion në: <https://www.euractiv.com/section/global-europe/news/russia-opens-humanitarian-base-in-serbia/>.

transportuese BRDM–2MS, tridhjetë tankeve T–72S; blerjen e gjashtë sistemeve të mbrojtjes ajrore, raketa të dirigjuara anti-tanke Kornet, etj.<sup>119</sup>

Forma e tretë e bashkëpunimit ushtarak midis Federatës Ruse dhe Serbisë është pëmes ushtrimeve ushtarake të përbashkëta të shpeshta. Që nga 2014, ushtrimet e përbashkëta ushtarake midis Rusisë dhe Serbisë ishin të shpeshta, nganjëherë duke përfshirë edhe satelitin tjetër të Rusisë, Bellorusinë. Kështu, në 2014, manovrat e përbashkëta ushtarake të quajtura “SREM–2014,” janë mbajtur në Nikinci, në afërsi të Beogradit. Është vlerësuar se në këtë ushtrim kanë marrë pjesë 197 trupa serbe dhe 207 ruse, kryesisht parashutistë këmbësorë, dhe gjatë këtyre janë demonstruar edhe lëshimet me parashutë të mjeteve transportuese, dhe kjo është bërë me pjesëmarrje të modeleve të ndryshme të aeroplanëve dhe helikopterëve.<sup>120</sup> Që nga viti 2015, ushtrimet ushtarake trilaterale me emrat sugjestivë “Vëllazëria Sllave” janë organizuar rregullisht. Pas Forcave të Armatosura të Serbisë dhe të Rusisë, në ushtrim kanë marrë pjesë po ashtu edhe anëtarët e forcave të armatosura të Bellorusisë. Çdo vit nikoqiri i këtyre manovrave ka qenë një vend tjetër, dhe më 2016 dhe 2019 këto manovra u organizuan në territorin e Serbisë. Serbia mungoi nga ushtrimi i vitit 2020, për shkak të një trysnie të fuqishme politike nga Perëndimi, por vitin e ardhshëm Serbia përsëri mori pjesë në këto ushtrime të përbashkëta ushtarake me Rusinë dhe Bellorusinë. Ashtu siç u shpall në uebsajtin e Ministrisë Serbe të Mbrojtjes, “këto ishin ushtrime taktike të njësisve speciale me gjuajtje.”<sup>121</sup> Në ushtrimet e fundit nga viti 2021, Serbia përfaqësohej me rreth 100 ushtarë, mbi 300 ishin nga Bellorusia, dhe rreth 500 ushtarë ishin të Federatës Ruse. Po ashtu, ka edhe shumë vite të ushtrimeve tradicionale VARS [Vëllazëria e Ajrorëve të Rusisë e të Serbisë], domethënë të ushtrimeve taktike fluturoese në të cilat pilotët rusë dhe serbë i shkëmbejnë përvojat dhe dituritë në fushën e shfrytëzimit luftarak të aeroplanëve.<sup>122</sup> Në të njëjtin vit, forcat e armatosura të

---

<sup>119</sup> Shih, Nebojša Vuković. "Војна сарадња Србије и Русије – стање и перспективе," *Међународна политика* ("Bashkëpunimi Ushtarak Midis Serbisë dhe Rusisë – Gjendja dhe Perspektivat"), 2023 (1187), fq: 59–80.

<sup>120</sup> Radio Free Europe, Belgrade Plays Down Joint Military Exercise ith Russia, November 14, 2014, Në dispozicion në:

<https://www.rferl.org/a/serbia-plays-down-russia-military-exercise/26692231.html>.

<sup>121</sup> Vuković, *op.cit.*

<sup>122</sup> Ministry of Defence of Republic of Serbia, International Flight-Tactical Exercise “BARS 2021,” 11 tetor 2021. Në dispozicion në: <https://www.mod.gov.rs/eng/17931/medjunarodna-letno-takticka-vezba-bars-2021-17931>.

Rusisë dhe të Serbisë i kanë përmbushur ushtrimet e përbashkëta ushtarake ajrore të quajtura “Mburoja Sllave 2021.”<sup>123</sup>

Marrë në tërësi, vlerësohet se bashkëpunimi ushtarak midis Serbisë dhe Federatës Ruse, kur puna vjen te veprimtaritë e përbashkëta, u rrit në mënyrë progresive vit pas viti, kështu që në vitin 2021 u realizuan rreth 90 veprimtari që kishin të bënin me fushën ushtarake.<sup>124</sup>

Interesat ekonomike të Rusisë në Ballkan: Rusia nuk e ka ndonjë interes të veçantë ekonomik në Kosovë, por ajo ka të tilla në Serbi si dhe në vendet e tjera në rajon. Në Rusi biznesi e politika, dhe oligarkët e politikanët janë të ndërlidhur. Investimet ruse vijnë në forma të shumta, dhe atë përmes kompanive publike, të tilla si Gazpromi dhe Lukoili, apo përmes kompanive private, të cilat janë rëndom në pronësi të oligarkëve që kanë lidhje të ngushta me Kremlinin. Po ashtu, investimet ruse në Ballkan shpesh herë kanë qenë të kanalizuar përmes vendeve të treta. Një shembull i tillë i shquar është kompania ruse e minierave Solway, e cila vepron në Maqedoninë Veriore dhe është e regjistruar në Zvicër. Si një qasje e përgjithshme, investimet ruse kanë tentuar të përqendrohen në sektorët strategjikë, të tillë si energjia, nafta dhe gazi, patundshmëria.<sup>125</sup> Për shembull, Lukoil është e pranishme në Serbi, Maqedoni të Veriut dhe në Mal të Zi, dhe Rusia e përbën pjesën më të madhe të gazit në Bosnje, Serbi dhe Maqedoni të Veriut, dhe është edhe një furnizues i rëndësishëm i naftës së papërpunuar në Serbi.<sup>126</sup> Sipas shifrave të Agjencisë së Bashkimit Europian për Bashkëpunimin e Regullatorëve të Energjisë, ndikimi i Rusisë në energji është më i madhi në Serbi, Maqedoni të Veriut dhe në Bosnje e Hercegovinë, ku ajo i furnizon afër 100% të nevojave të gazit dhe është pronare e disa pasurive, të tilla si rrjeti i stacioneve të benzinës Lukoil.<sup>127</sup>

Ka shumë shembuj konkret të ndërlidhjes së investimeve ekonomike me agjendat politike. Kështu, Industria Serbe e Naftës (NIS), nga viti 2022 e ka Gazpromin si aksionarin e vet kryesor (me 50%). Kjo kompani ka bërë investime dhe sponsorime të mediave pro-Kremlinit,

---

<sup>123</sup> Airforce Technology, Russia and Serbia conclude Slavic Shield joint air defence exercise, 19 tetor 2021. Në dispozicion në: <https://www.airforce-technology.com/news/russia-serbia-conclude-slavic-shield-exercise/?cf-view>

<sup>124</sup> Vuković, *op.cit.*

<sup>125</sup> Center for Strategic & International Studies dhe Center for the Study of Democracy, Playbook: Understanding Russian Influence in Central and Eastern Europe, Washington DC, October 13, 2016. Në dispozicion në: <https://www.csis.org/analysis/kremlin-playbook>.

<sup>126</sup> Florian Bieber dhe Nikolaos Tzifakis (ed.), “The Western Balkans in the World: Linkages and Relations with Non-Western Countries,” *South East European Studies*, Vol. 20, 2009, fq. 195.

<sup>127</sup> European Parliament, Russia and the Western Balkans Geopolitical confrontation, economic influence and political interference, qershor 2023. Në dispozicion në: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2023/747096/EPRS\\_BRI\(2023\)747096\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2023/747096/EPRS_BRI(2023)747096_EN.pdf).

të shoqërisë civile dhe të segmenteve të tjerë shoqërorë në Serbi.<sup>128</sup> Këto veprimtari ekonomike të kompanive në pronësi të shtetit rus bëhen krahas me praninë aktive në Serbi të mediave ruse, të tilla si Sputniku. Kompania kombëtare e gazit, Srbijagas, është konsideruar gjatë si një rezervat i Partisë Socialiste të Serbisë (SPS), e cila është partia e Miloševićit dhe një partner i besueshëm i koalicionit të Partisë Progresive Serbe (SNS) të Vučićit.<sup>129</sup> Rusia është madje edhe më aktive me veprimtaritë ekonomike në *Republikën Serbe*, në Bosnje e Hercegovinë. Duke përfituar nga lidhjet e fuqishme me udhëheqësin pro-ruse të këtij entiteti, Rusia është tash investuesi më i madh në *Republika Srpska* (€547 milionë gjatë periudhës 2005 – 2026). Pesë kompani në pronësi ruse (energji dhe bankat) i arrijnë 42 për qind të të ardhurave të të gjitha bizneseve të jashtme.<sup>130</sup> Nga ana tjetër, sanksionet ekonomike të vendosura kundër Ruisë, si reagim ndaj luftës pushtuese në Ukrainë, nuk e kanë penguar bashkëpunimin e ngushtë ekonomik midis Serbisë dhe Ruisë. Pikërisht e kundërta. Një nga shembujt ndodhi më 29 maj 2022 – në kohën kur BE-ja ishte duke ushtruar trysni për ndalesa gjithëpërfshirëse në energjinë ruse – kur Presidenti Serb, Aleksandar Vučić e shpalli që vendi i tij e kishte nënshkruar një marrëveshje për një kontratë të re 3-vjeçare për gazin me Rusinë.<sup>131</sup> Një shifër tjetër e rëndësishme jepet nga gazeta ruse Komersant, sipas të cilës në fundin e vitit 2023, ishin nëntë mijë kompani ruse të regjistruara në Serbi (nga gjashtë mijë sa ishin të regjistruara në 2022).<sup>132</sup> Ky ishte vetëm një segment i bashkëpunimit më të gjerë dhe më intensiv që është duke ndodhur midis Federatës Ruse dhe Serbisë që nga fillimi i luftës në Ukrainë.

## **V. Implikimet për perspektivat e integrimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare**

Integrimi i plotë i Kosovës në sistemin ndërkombëtar është tregues i stabilitetit të këtij vendi, dhe, si i tillë, është i pazëvendësueshëm për përfundimin e suksesshëm të procesit të dialogut midis Kosovës e Serbisë. Marrëveshja e Brukselit e 27 shkurtit 2023 parasheh që Kosova dhe Serbia reciprokisht ta bëjnë të ditur që asnjëra nuk mund të shërbejë si përfaqësuese e tjetrës

---

<sup>128</sup> Jovana Lazić Knežević dhe Norman M. Naimark, “Serbia, Russia, and the New Great Game: After twenty years of uneasy peace in the Balkans, Belgrade is moving closer to Europe--but also displaying Russian-style autocracy while flirting with China,” *Hoover Digest*, 2020(4).

<sup>129</sup> Florian Bieber dhe Nikolaos Tzifakis, *op. cit.* p. 196.

<sup>130</sup> *Ibid.*

<sup>131</sup> Briefing of the European Parliament, *op.cit.*

<sup>132</sup> Danas, Rusi sve aktivniji u otvaranju firmi po Srbiji, 5 janar 2024. Në dispozicion në: <https://www.danas.rs/svet/komersant-srbija-firme-rusija>.

në arenën ndërkombëtare, dhe që Serbia nuk do ta kundërshtojë anëtarësinë potenciale të Kosovës në ndonjë organizatë ndërkombëtare.<sup>133</sup> Ndërkohë që Beogradi ishte pajtuar me këtë formulim, ashtu siç u shpjegua më sipër, ajo e vazhdon ta kundërshtojë anëtarësinë e Kosovës në Kombet e Bashkuara dhe në agjencitë e saj.

Ky qëndrim po ashtu rreshtohet me interesat ruse, meqë do të ishte e pakëndshme për Rusinë që t'i bëjë vërejtje anëtarësisë së Kosovës në KB nëse atë do ta pranonte Serbia. Sidoqoftë, madje edhe në mungesë të kundërshtimit serb, nuk mund të pre supozohet se Federata Ruse do të përmbahet nga ushtrimi i vetos në Këshillin e Sigurisë të KB, gjë kjo që është një hap i domosdoshëm procedural për anëtarësinë e Kosovës në KB.<sup>134</sup> Shkaku parësor qëndron në prirjen e Kremlinit për ta faktorizuar anëtarësinë e Kosovës me interesat e Ruisë në fqinjësinë e saj të afërt, domethënë në Krime, si dhe në hapësirat e tjera në Ukrainë dhe në Gjeorgji të cilat Rusia i ka njohur në mënyrë të paligjshme. Konsiderata dytësore është që anëtarësimi i Kosovës në KB në mënyrë të qenësishme do të rezultonte në një rishikim të Rezolutës 1244 të KS KB, dhe së bashku me përfundimin e Misionit të Administrimit të Përkohshëm të KB, dhe rrjedhimisht mund të ndikojë mandatin e KFOR-it (Forca e Kosovës).<sup>135</sup> Për më tepër, kjo e nënkupton që pa njohje eksplicite nga Serbia, Rusia do ta humb ndikimin e vet mbi Kosovën dhe, rrjedhimisht, edhe shtysën e vet mbi Beogradin. Kjo humbje do t'i kufizonte në një mënyrë domethënëse aftësitë de stabilizuese të Ruisë në Ballkan. Kështu, në rrethanat mbizotëruese të cilat varen nga epilogu i luftës në Ukrainë dhe nga fati i regjimit të Putinit, anëtarësia e Kosovës në Kombet e Bashkuara është e porealizueshme. Për më tepër, në saje të strukturës vendimmarrëse të bazuar në konsensus në kuadër të OSBE-së, për shkaqe analoge, Rusia do ta blloktojë çdo përpjekje të Kosovës për ta arritur anëtarësinë në këtë organizatë, para se ta arrijë anëtarësinë e Kombeve të Bashkuara. Prandaj, pjesëmarrja e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, para marrjes së anëtarësisë në KB, do të jetë e kufizuar në entitetet ku Ruisë i mungon fuqia e vetos, përfshirë agjencitë e KB, Interpoli, dhe institucionet Euro-Atlantike.

---

<sup>133</sup> European Union External Action Service, Belgrade-Pristina Dialogue: Agreement on the path to normalisation between Kosovo and Serbia, 27 shkurt 2023, Brussels. Në dispozicion në: [https://www.eeas.europa.eu/eeas/belgrade-pristina-dialogue-agreement-path-normalisation-between-kosovo-and-serbia\\_en](https://www.eeas.europa.eu/eeas/belgrade-pristina-dialogue-agreement-path-normalisation-between-kosovo-and-serbia_en).

<sup>134</sup> Karta e KB, Kapitulli II, Neni 4.2, Në dispozicion në: <https://www.un.org/en/about-us/un-charter/chapter-2>.

<sup>135</sup> Rezoluta 1244 (1999) e Këshillit të Sigurimit të KB, Aneksi 2. Në dispozicion në: <http://unscr.com/en/resolutions/doc/1244>.

Nga ana tjetër, duke pasur parasysh që anëtarësia në NATO<sup>136</sup> dhe në Bashkimin Evropian<sup>137</sup> nuk e ka të nevojshme anëtarësinë paraprake në Kombet e Bashkuara, Rusia nuk ka ndonjë ndikim vendimmarrës në këto dy organizata që janë të një rëndësie ekzistenciale për Kosovën. Mirëpo, procesi i integritit të Kosovës në NATO është i penguar nga mosnjohja e Greqisë, Rumanisë, Sllovakisë dhe Spanjës. Pos kësaj, edhe Qiproja, krahas me vendet e përmendura, e pengon integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Opinioni Këshillues i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës pa kurrfarë mëdyshje pohonte se kjo nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare. Mirëpo, me përjashtim të Greqisë, shtetet e tjera mos-njohëse argumentojnë se shpallja e pavarësisë ishte shkelje e të drejtës ndërkombëtare për shkak të mungesës së miratimit të Serbisë dhe mungesës së autorizimit të Këshillit të Sigurisë së KB.<sup>138</sup>

Në një mënyrë ironike, qëndrimet e këtyre vendeve të BE-së që ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, asaj ia mohon perspektivat e anëtarësisë në NATO dhe në BE. Rrjedhimisht, ky fakt Rusisë i jep një ndikim të konsiderueshëm në procesin e dialogut të ndihmuar nga BE-ja dhe i kontribuon de stabilizimit të situatës në rajon. Varësia e perspektivës së anëtarësisë së Kosovës në NATO dhe në BE nga miratimi i Serbisë dhe/ose Rusisë për pavarësinë e Kosovës, Rusisë ia jep një shtysë të rëndësishme mbi Serbinë, duke e penguar progresin drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve me Kosovën. Duke i pasur parasysh këto rrethana, është sfiduese të parashihet një marrëveshje ligjërish të obligueshme midis Kosovës dhe Serbisë të ndihmuar në mënyrë të suksesshme nga BE-ja, e cila do të hapte rrugë për integrimin e Kosovës në NATO dhe në BE, meqë kjo është në kundërtënie me interesat jetike të Moskës në Ballkan. Ndikimi i Rusisë në dialog do të ulet kur Kosova ta arrijë statusin e kandidatit për anëtarësi në BE dhe planin e anëtarësimit në NATO. Në atë pikë, rëndësia e njohjes së Kosovës nga ana e Serbisë, apo e miratimit të Rusisë për anëtarësinë në KB do të zvogëlohet. Mirëpo, kjo varet nga një zhvendosje e qëndrimeve aktuale që mbahen nga pesë vendet mos njohëse të BE-së.

---

<sup>136</sup> Traktati Veri-Atlantik nuk e kërkon anëtarësinë në KB për shtetet e veta nënshkruese. Italia dhe Portugalia, si vende themeluese të NATO-s, nuk ishin anëtare të KB deri në fundin e vitit 1955, ndërsa Gjermania Perëndimore, e cila iu bashkangjiti NATO-s në vitin 1954 nuk ishte anëtare e KB deri në vitin 1973.

<sup>137</sup> Traktati i Lisbonës nuk e kërkon anëtarësinë në KB për anëtarët e vet, shih: Consolidated Version of the Treaty on European Union, Në dispozicion në: [https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:2bf140bf-a3f8-4ab2-b506-fd71826e6da6.0023.02/DOC\\_1&format=PDF](https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:2bf140bf-a3f8-4ab2-b506-fd71826e6da6.0023.02/DOC_1&format=PDF).

<sup>138</sup> Për shembull, shih: Edward Joseph et al, From Crisis to Convergence: A Strategy to Tackle Instability in the Balkans, janar 2022, ilson Center, <https://www.wilsoncenter.org/sites/default/files/media/uploads/documents/SAIS%20FPI%2C%20WWICS%20Report%2C%20From%20Crisis%20to%20Convergence%2C%20Strategy%20to%20Tackle%20Balkans%20Instability.pdf>

## VI. Përfundimi dhe gjetjet kyçe

Që nga shekulli nëntëmbëdhjetë, Ballkani ka qenë një terren gjeopolitik i ndërveprimit të interesave midis Rusisë dhe fuqive Perëndimore. Në disa momente politike kyçe, interesat e Rusisë janë pajtuar me ato të fuqive Perëndimore – apo, të paktën, me disa prej tyre – dhe në disa të tjera ato janë përplasur.

Procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe, në këtë kontekst, çështja e konfliktit midis Kosovës dhe Serbisë nuk është e ndryshme. Mirëpo, mbase për fatin e keq të të gjitha palëve, në pjesën më të madhe të viteve të vona 1990 e deri më sot, Rusia e perceptonte Perëndimin (domethënë, SHBA-të dhe vendet kryesore evropiane) si rival në Ballkan. Kështu, që nga shpërthimi i luftës në Kosovë, më 1998–1999, e deri më sot, Kosova është shndërruar në një pasqyrë që e paraqet ndikimin në rënie të Rusisë në Ballkan dhe në arenën ndërkombëtare në përgjithësi.

Ashtu siç u skicua në këtë punim, burimi kryesor i armiqësisë së Federatës Ruse me Perëndimin në periudhën pas Luftës së Ftohtë është zgjerimi në lindje i strukturave euro-atlantike – dhe posaçërisht i NATO-s. Rusia e percepton NATO-n përmes prizmit të Luftës së Ftohtë dhe është në një ndjekje të përhershme të asaj që të njihet si një superfuqi. Në kuadër të kësaj paradigme, Rusia përpiket ta ketë një avan-post të interesave të veta në Ballkan, që do të thotë një gur shahu në terrenin euro-atlantik. Për këtë qëllim, Rusia mbështetet me të madhe në shfrytëzimin e, kryesisht, nacionalizmit serb dhe të ideologjisë ortodokse pan-sllave. Në kalkulatorin gjeopolitik të Moskës, Ballkani i shërben dy qëllimeve: së pari, për ta goditur Perëndimin në hallkën më të dobët të tij në prapa-oborrin euro-atlantik, dhe, njëkohësisht, për t'i forcuar ambiciet e veta hegjemone në “në fqinjësinë e afërt.” Megjithatë, Kosova dhe Ukraina e kanë demonstruar që ambicia e Rusisë për një status të superfuqisë që e balancon Perëndimin është vetëm një përpjekje jorealiste.

### *Gjetjet kyçe:*

Gjetja kryesore e nënvizuar në këtë punim është që Rusia nuk e ka pasur konsistencë në qasjen e saj ndaj konfliktit në mes Kosovës dhe Serbisë. Në vend të kësaj, pozita e saj ka ndryshuar dhe është luhatur varësisht nga evoluimi i kontekstit të marrëdhënieve të Rusisë me Perëndimin.



Konkretisht, janë tetë gjetje kryesore që e shpjegojnë qëndrimin e Federatës Ruse gjatë të tërë shpërbërjes së Jugosllavisë, përfshirë edhe procesin e dialogut midis Kosovës dhe Serbisë që është duke ndodhur nën ombrellën e BE-së dhe me përkrahjen aktive të SHBA-ve:

*E para*, gjatë epokës së Jelcinit, qasja e Ruisë ndaj krizës në ish-Jugosllavi, në përgjithësi, përfshirë edhe Kosovën, e pasqyrore hutimin e Moskës lidhur me vendin e saj në një mjedis thellësisht të ri ndërkombëtar që po shfaqej me përfundimin e Luftës së Ftohtë. Politikat e Ruisë ndaj shpërbërjes së ish Jugosllavisë, përfshirë edhe Kosovën, gjatë kësaj periudhe trajtësoheshin nga dy faktorë: së pari, marrëdhëniet e përgjithshme të Ruisë me Perëndimin; së dyti, pikëpamjet e vendim-marrësve kyç të politikës së jashtme në Moskë (domethënë, Kozyrevi përballë Primakovit).

*E dyta*, me shpërthimin e luftës në Kosovë, Rusia ishte pjesë e të gjitha përpjekjeve kryesore ndërkombëtare për ta zgjidhur krizën. Kështu, Rusia i përkrahu tri rezoluta të KS KB për Kosovën, të përvetësuara sipas Kapitullit VII të Kartës, por refuzoi t'i lejojë Këshillit të Sigurimit që ta autorizojë në mënyrë eksplicite intervenimin e NATO-s për t'i ndërprerë mizoritë masive të Serbisë në Kosovë. Me përfundimin e luftës në Kosovë, në qershor 1999, Rusia votoi në favor të Rezolutës 1244 (1999) së KS KB që e parashihte tërheqjen e të tërë aparatit shtetëror dhe të sigurisë të RFJ/Serbisë nga Kosova dhe që Kosovën e vinte nën administratën ndërkombëtare (përfshirë misionin për zbatimin e paqes të udhëhequr nga NATO-ja).

*E treta*, Rusia nuk i pranoi rezultatet përfundimtare të përpjekjeve paqësore ndërkombëtare për Kosovën, dhe atë kryesisht si reagim nga pakënaqësia e saj e përgjithshme me Perëndimin. Kështu, Rusia e luajti një rol kyç në kuadër të Grupit të Kontaktit gjatë Konferencës së Rambouillet-së, në shkurtin 1999. Mirëpo, Rusia e tërhoqi përkrahjen e saj ndaj Marrëveshjes së Rambouillet-së, duke mos marrë pjesë në ceremoninë e nënshkrimit në Paris. Skenari i njëjtë u përsërit gjatë bisedimeve të Vjenës për statusin përfundimtar të Kosovës, më 2006–2007. Rusia ishte një pjesë aktive e këtij procesi, por në momentin e fundit, refuzoi ta miratonte në KS KB propozimin për zgjidhjen e statusit të Kosovës, të paraqitur nga i Dërguari i KB, Martti Ahtisaari.

*E katërta*, ndërsa ishte jashtë tabelës së bisedimeve, në dialogun e ndihmuar nga BE-ja që filloi në marsin 2011, qëllimi kryesor i Federatës Ruse ishte që ta parandalonte dhe pengonte përfundimin e suksesshëm të procesit të dialogut, duke u përpjekur për ta diskredituar BE-në dhe Perëndimin, dhe që atë rol ta rikthente në KS KB.

*E pesta*, Moska procesin e dialogut nuk e sheh si të izoluar nga qëllimet e veta të përgjithshme gjeopolitike në Ballkan – dhe posaçërisht nga mbajtja e Serbisë dhe serbëve brenda orbitës ruse dhe nga pengimi i zgjerimit të BE-së dhe të NATO-s në rajon. Pavarësisht se Serbia edhe pse është në procesin e negociatave për anëtarësim në BE, ajo ka refuzuar që ta përafroj politikën e saj të jashtme me atë të BE-së në raport me Rusinë.

*E gjashta*, lufta në Ukrainë e ka shpalosur thellësinë e marrëdhënieve politike, të sigurisë dhe ekonomike midis Rusisë dhe Serbisë, të cilat janë forcuar edhe më tutje me ardhjen në pushtet të Partisë Progresive Serbe të Vučićit, dhe të Partisë Socialiste të Dačićit më 2012. Rusia përpiqet ta shfrytëzojë rastin e Kosovës, domethënë intervenimin e NATO-s më 1999 dhe shpalljen e pavarësisë më 2008, si një monedhë shkëmbimi për grumbullimin e përfitimeve në Ukrainë dhe në Gjeorgji, për t'i legjitimuar luftërat e veta aneksuese.

*E shtata*, mungesa e unanimitetit përbrenda komunitetit euro-atlantik ndaj Kosovës – me pesë vende të BE-së që ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës – ka krijuar më shumë hapësirë manovruese për Rusinë për t'i penguar përpjekjet perëndimore dhe për t'u angazhuar me këmbëngulje në rrënimin e themeleve të shtetësisë së Kosovës dhe për de stabilizimin e rajonit. Kjo hapësirë është krijuar nga fakti se për integrimin e Kosovës në BE dhe NATO nuk është i nevojshëm anëtarësimi paraprak në KB, ku Rusia e posedon të drejtën e vetos në Këshillin e Sigurimit.

*E teta*, një shtysë e rëndësishme për Rusinë për ta ndikuar dialogun Kosovë–Serbi është fuqia e saj për ta bllokuar anëtarësinë e Kosovës në KB dhe në OSBE – anëtarësia e papenguar e Kosovës në organizatat ndërkombëtare është një nga shtyllat kyçe të marrëveshjeve të Brukselit/Ohrit, të vitit 2023.